



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.03.2022**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Defrim Kafexhiu**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së dhe përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01/Kuvendi i Komunës

Nr./Br./No 301 Nr. i faq./Br.sht./No.pg 01

Data/Datum/Data 29.04 / 2022

1. **Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Rahovecit;**
2. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
3. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të komunës;**
5. **Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- rregullores për menaxhimin e Pasurisë jo financiare;**
6. **Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale(inventari) për vitin 2021;**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Draft strategjisë komunale për informim dhe komunikim 2022-2025;**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e çmimit “ Ukshin Hoti “;**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P – 71510066 – 00386 – 1,ZK – Pastasel;**
10. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P – 71510057 – 02172 – 1,ZK –Rahovec;**
11. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e vendit (lokacionit) për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit te fshatit Çifllak;**

12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e vendit(lokacionit) për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe me gjërë;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private - për interes publik;
14. Informatë për listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft vendimit për shpalljen e pronave me interes te përgjithshëm;
16. Informatë mbi zbatimin e projektit te mirëmbajtjes dimërore të rrugëve ne Komunën e Rahovecit;
17. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e komisionit ad-hoc për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkurruar për Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe;
18. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit te vendimit Nr.01/272, të datës 28.02.2022 për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit te fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi – I nderur kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtarë të kuvendit, media, përfaqësues të organizatave dhe ju qytetarë të dashur të komunës së Rahovecit. E fillojmë mbledhjen e tretë të rregullt të kuvendit me rendin e ditës që është organizuar nga kryetari dhe kryesuesi e që me pastaj ka kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa për shqyrtim, gjithashtu e kemi edhe një pikë shtesë **betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës së Rahovecit**, të cilin e ftojë që të bëjë betimin si anëtar me i ri i Kuvendit.

Lirigzon Kastrati – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Unë Lirigzon Kastrati, betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri pa anime me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i kuvendit te komunës se Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

Kryesuesi – Para se me fillua me leximin e pikave të rendit të ditës, ju njoftoj se e kemi edhe një pikë shtesë të rendit të ditës, Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01/272, të datës 28.2.2022 për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, ku për shkak të shfuqizimit të një udhëzimi administrativ në bazë të cilit edhe u bë vendimi dhe tash na duhet të bëjmë plotësim ndryshimin dhe e vendosim si pikë te fundit të rendit te ditës. E qesim në votim. Konstatoj se me shumicë të votave miratohet si pikë shtesë e rendit te ditës, që është i plotësim ndryshimit te vendimit 01/272, të datës 28.02.2022 për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Të nderuar anëtar te kuvendit, e qesim në votim rendin e ditës me pikat shtesë. Konstatoj se me shumicë te votave miratohet rendi i ditës me pikat shtesë. Kalojmë ne pikën e parë te rendit te ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi – Për arsyetimin tuaj procesverbalit ka ardhur me vonesë në emailin tuaj për shkak të volumit të madhe që ka pasur dhe për shkak te kohës që i duhet për lektorim dhe që është ne proces e sipër. Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar sa I përket procesverbalit, e qesim ne votim. Konstatoj se me shumicë te votave miratohet procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë ne pikën e dytë te rendit te ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Bejtullah Deliu – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblistë, media dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë desha me u ndal pak te drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku kemi pa një lajmërim për shtyrje të subvencioneve me arsyetimin se ka interesim të madhe të OJQ-ve për të

aplikuar dhe kjo është diçka e mirë pasi është mirëkuptuar nga drejtoria, mirëpo unë desha të ndalem rreth subvencionimeve të OJQ-ve siç janë shoqëritë kulturore artistike, klubet sportive. Ky lloj i subvencionimit është praktikua sidomos te klubet sportive, kështu që desha t'i bëj një pyetje drejtorit nëse ende në këtë rrugë me të njëjtin qëllim apo kanë mendua një strategji më afatgjatë lidhur me gjeneratat që i kemi, ku për fat të keq neper klube sportive nuk është se ky lloj subvencioni ka treguar sukses ne prurjen apo ardhjen e ndonjë talenti eventual ne komunën tonë. Pra, subvencionimi po bëhet, por, pa ndonjë strategji me vite me radhë dhe unë mundem me marr një shembull pozitiv para se me dal te ato negative që i konsideroj si kritike nga drejtoresha e kaluar për disa veprime neper disa lokacione që duhet me falënderua që i ka nxjerr disa pjesë rekreative që po i shfrytëzojnë djemtë e ri neper disa lagje dhe ku po zhvillojnë sport. Kështu që kjo jep shkas me mendua për ju si drejtori e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që interesimi nga rinia është shumë i madh për tu angazhuar nëpër sporte, por, ky lloj subvencionimi e sidomos në pjesë rurale nuk është fare i përfshirë dhe që kemi ndërtuar disa objekte të mëdha sportive si në Xërxe. Ratkoc, Krushë. Por, që ato objekte po rrënohen dhe nuk ndonjë aktivitet të mirëfilltë, ku gjithashtu e kemi edhe palestrën në Rahovec ku klubet tona më shumë janë koncentruar të marrin lojtarë të huaj pasi punohet shumë pak në sjelljen e talenteve apo për të punuar me shumë për të rritur talente. Pra, a keni menduar ju si drejtori e kulturës rinis dhe sportit, që këtë lloj të subvencionimit të vendosni një kriter për aplikim që klubet apo shoqëritë kulturore artistike, të tregoj në te ardhme afatgjatë, jo një vjeçare por më shumë se 3 vjet se ku është synimi i klubit pastaj çfarë hapa do të ndërmerr që nga komuna e jonë të nxirren talente, pasi në këtë drejtim mendoj se brenda 3-4 viteve të kaluara nuk mundeni me i gjet as 3-4 persona që kanë treguar sukses nëpër klube apo shoqëritë aksionare që mundemi me u krenua si komunë. Kështu që nëse kjo qëndron ende atëherë kjo është mangësi te menaxhimi i kësaj drejtorie apo i këtij dikasteri dhe do të ishte mirë me u përmirësuar në këtë pikë dhe të shohim që të nxjerrim kuadro te reja nga komuna e që ndoshta ne këtë subvencionim do te ishte mirë të përfshihet nga fshatrat pasi kemi trajner te ndryshëm dhe janë ekiye me profesionale që të ofrohen talente dhe sigurisht te angazhohemi më shumë që të punojmë në këtë pikë. Sa i përket pjesës së kulturës mendoj se kjo është shumë me rëndësi pasi që më herët kemi pasur edhe teatër e që tash nuk e kemi, ku kemi studente aktor regjisor te komunës që punojnë jashtë komunës se Rahovecit e që këtu nuk mund ta japin kontributin e tyre pikërisht ndoshta nga mos ftesa apo krijimi i hapësirës se kuadrove që i kemi. Po ashtu e kemi pa një postim te komunës për subvencionimin e bujqve që po vazhdon me një retorikë te njëjtë me subvencionimin e pjesëve mekanike, që edhe këtu unë mendoj se duhet një strategji pak më e shëndoshë dhe më afatgjatë, pasi subvencionimi mendoj se do të ishte më në rregull të jepet në fillim të punës së tyre pasi siç e dimë ky vit për bujqit është me shumë se pesë herë me i vështirë në aplikimin fillestar të punimit të tokës pasi edhe pesticidet edhe plehurat artificiale kanë shkuar me një çmim enorm dhe kjo sigurisht se është shumë e vështirë për bujqit tanë, kështu që do të ishte mirë të koncentrohemi edhe në produktin e fundit se si mund të plasohet apo të mos i mbetet produkti i tyre neper arat e tyre, pasi këtë ballafaqim e kemi pasur edhe gjatë fushatës ku isha kategorikisht kundër këtij lloj subvencionimi pasi që bujqit tanë kanë punuar edhe para se me u subvencionua këta multikultivator, pllugjë, freza e plot te tjera por problemi i tyre është plasimi i produktit apo investimi fillestar që kosto është shume e lartë. Është mirë shume që keni marr iniciativën për ta bërë pikën grumbulluese dhe ndoshta është dashur shume me tepër te koncentrohemi dhe nëse ne i sigurojmë se produktet e tyre kanë ku te shkojnë, ata do te keni edhe me shume motiv për ti punuar tokat e tyre që me pas te siguruar se ku do ta plasojnë produktin e tyre krejt ne fund. Unë mendoj që një strategji apo ide mundet që ne bashkëpunim me bizneset tona lokale që me organizua një takim bashkërisht bujqit me biznesmenë shoqata të afaristëve dhe të jepet një ide se si mundet produktet e tyre te gjejnë vend në Kosove, por, kemi edhe biznesmen të komunës tonë që i plasojnë jashtë, pra, këtu të bëhet koncentrimi më i madh. Por, sa e shoh që në vend që të

lehtësohen bizneset e komunës tonë ju keni filluar me i rëndua më tepër këto biznese duke aplikuar një taksë shtesë që nuk ka ndodhur më herët që në veprimtaritë ku ceket informata e biznesit të subjekteve përveç 100% që taksohen në veprimtarinë kryesore ju i taksoni bizneset tani e tutje edhe me veprimtari tjera që ceken në informatë me 50% të kostos së parë. Mendoj që komuna duhet t'i lehtësojë bizneset e jo t'i vështirësoj ato, komuna duhet të shikoj mundësi bizneseve që të krijoj hapësira që të kenë bashkëpunim me bujqit dhe jo të ju vështirësohet puna në operimin e tyre. Kështu që besoj që do të kemi mirëkuptim edhe nga qeverisja por edhe nga kolegët që të bëhet një ndryshim që të mos ngarkohen bizneset edhe për 50% taksës që ata të paguajnë për veprimtaritë të cilat nuk i zhvillojnë, pasi ata e kanë shfrytëzuar momentin që në ARBK lejohet me një kod të regjistroj edhe veprimtari tjera që mund të ndërlidhen me veprimtarinë kryesore por nuk do të thotë që ju ta shfrytëzoni atë hapësirë dhe t'i taksoni për herë të parë bizneset në këtë nivel.

Burim Krasniqi - Faleminderit kryesues, përshëndetje ekzekutiv, kolegë të nderuar. Ne si grup i asamblistëve të LDK-së i kemi disa pyetje, e para dhe e dyta kanë të bëjnë me drejtorin e shëndetësisë së qëndron fakti drejtoreshë se disa mjekë për kujdestari kanë fituar të drejtën përmes gjykatës me vlerë 80,000 euro nga komuna e Rahovecit, e po ashtu edhe për shujta kanë fituar në vlerë 24,000 euro gjithashtu edhe këtu mjekët edhe sa kam informacion të vlera e 24,000 eurove është humbur kontesti për shkak të mos ankimimit nga ana e avokatit të kontraktuar prej komunës. Komuna me avokatin që e ka të kontraktuar a ka të parapamë procedura penale ndaj avokatit të kontraktuar nëse i njëjti nuk ushtron ankesë brenda afateve ligjore, që nënkupton se lejon fitimin e mjeteve materiale pa procedure të ankimimit d.m.th. është shkelje procedurale. Nëse kjo nuk qëndron mundemi me pas një përgjigje mirëpo nga ajo që kam informacione mendoj se kjo ekziston. Te drejtorja e kulturës, ne si grup i asamblistëve të LDK-së deshëm me pas një informacion për katër vitet e kaluara e deri me sot, a ka pasur ndonjë aktivitet kulturor apo artistik në shtëpinë e kulturës në Krushë të Madhe, Ratkoc, Xerxe dhe Drenoc. Pastaj të subvencionet në bujqësi ne si grup i asamblistëve të LDK-së e kemi një pyetje pak me ndryshe prej PDK-së, pasi në facebook e pash një ftesë për pagesë të 20% të participimit për mekanizma bujqësor 2020. Nuk e di a është ligjore që të bëhet një shpallje për mekanizma bujqësorë qoftë si grant, si subvencion ose si pagesa direkte në mungesë të mjeteve materiale dhe nëse nuk ka mjete materiale atëherë a lejohet me shpall listën përfituese dhe a është ligjore kjo. Po ashtu edhe kërkesa e fundit për ju kryesues dhe kryetar që në ora 11:00 me marr një pauzë që të kemi mundësi me shkua për homazhe në Opterushë dhe Retijë që me shkua edhe si asamble komunale.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, anëtarët e kuvendit, mediat, përfaqësues që e mbikëqyrin këtë seancë dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë nuk e kuptova që a ishin pyetjet e z. Bejtullah Deliu apo diskutim edhe pse po besoj që ishte një diskutim i frytshëm. Subvencionimi i organizatave jo qeveritare nga fondi i DKRS-së është tepër interesant të theksohet dhe ndoshta do të ishte mirë me hyje në webfaqe me i gjet faktet pasi asnjëherë se sa këto katër vitet e fundit nuk janë subvencionue OJQ-të qofshin ato klube sportive qofshin shoqëritë kulturore artistike apo organizatat që merren me rini apo qytetarët që kanë nevojë të veçanta, pra nëse e shohim ka vlera të pakrahueshme. U tha se nuk ka pasur asnjë talent dhe ju mund të shkoni në palestrën sportive në qytet mund të shihni shumë talent që merren me aktivitete sportive të disiplinave të ndryshme që unë vazhdimisht i kam mbështet edhe me fondin e DKRS-së pasi edhe me fondin e kryetarit ka përkrahje të vazhdueshme, pasi faktet ekzistojnë se ka një gjallërim dhe dinamizëm të jetës kulturore sportive dhe rinore në komunën tonë. Kjo është një e vërtetë e pamohueshme që s'mundet me mohue as Bejtullah Deliu dhe askush tjetër pasi faktet janë të gjalla dhe relevante dhe ekzistojnë. Te subvencionimi, e kemi lodhur opinionin publik në fushat parazgjedhore, pasi jam shumë i saktë dhe i drejt sa i përket kësaj pasi e keni ditë se ka një ankesë në OSHP dhe e dini gjithashtu se edhe kësaj ditë OSHP-ja ende nuk funksionon dhe gjithashtu e keni ditur se

ka një vonesë dhe madje ka pasur situata ku keni qenë totalisht te dezinformuar sepse participimi për këto që i japim tash fillon sot edhe pse janë te 2020 sepse lista e përfituesve atëherë u shpall dhe ne nuk mund te qëndrojmë indiferent karshi asaj që ka ndodhur dikur sepse janë vendime te protokolluara dhe është liste e publikuar që mund te kenë qasje që te gjithë. Dhe tash nëse ka ndryshue gjendja pasi e shohim participimin ka një komision verifikimi dhe dikush ka mundur te jetë fermer para dy vite kurse sot mundet me qenë ne Gjermani apo ne Zvicërr, kështu që do te shohim se a ka bazë ajo që ndodhur dikur kur është publikuar. Pra u bë shume mire me nënshkrua kontratën pas intervenimit dhe ndërhyrjes se KDI-së dhe tash ne I kemi nënshkrua kontratat për shpërndarjen e mekanizmave bujqësor. Pastaj se ky mekanizëm bujqësor a ka prodhues efekte pozitive apo negative dhe shume mire qe e ngriti si çështje Bejtullah Deliu, mirëpo duhet me pae se qysh e përjetojnë apo si e prekin fermerët apo bujqit dhe jo unë si kryetar I komunës apo dikush prej asamblistëve dhe do te ishte mire me dal ne terren dhe mundeni me pae, nëse ata janë te pakënaqur me mekanizmin bujqësorë me pajisjet që I kanë marr për nevoja të fuqizimit angazhimit apo rritjes se kapaciteteve te tyre për ta punuar tokën bujqësore atëherë jemi ne rregull. Pra sot fillon participimi dhe po besoj se javën tjetër fillon edhe shpërndarja e mekanizmave bujqësore. Sa I takon obligimeve financiare që I ngriti Burim Krasniqi, normalisht që asnjëherë nuk kemi thane qe jemi komunë që nuk kemi obligime por po ashtu ne kemi marr përsipër që këto obligime apo detyrime kontraktuale të i shtyjme gjate procesit por ne me fermerët dhe bujqit dojmë me qëndrua mire dhe te saktë përkundër një vonesë te madhe te shpërndarjes se mekanizmit bujqësor, kështu që a do te ketë thirrje te reja sa i përket mekanizmave bujqësor mendoj se kjo është diskutabile tani, që ndoshta edhe ne e shohim se nuk ka nevojë tash e tutje për mekanizëm bujqësor por që mund te ketë nevojë për forma te tjera te subvencionimit te fermerëve apo bujqve tanë. Sa i takon ndryshimit te qasjes se subvencionimit te fermerëve, ne sigurisht se do ta diskutojmë por thirrjet që janë bërë me herët dhe kanë përfundua me sukses dhe janë nxjerr përfituesit dhe janë nënshkrua kontratat, sigurisht që nuk mund te mos ju qëndrojmë besnik për shkak se jam kryetar i komunës dhe i zgjedhur nga populli dhe duhet me i shfrytëzua te gjitha mundësit e me i shpërndaje mekanizmat bujqësor, pasi ata që janë përfitues me siguri ka fillue participimi prej tyre ne raportin 20% ata kurse 80% ne si komunë. Pra te gjitha procedurat janë krye ne rregull por vonesat kanë ndodhur si pasojë e një ankesë që ka ndodhur nga një operator e që e ka vonue procesin dhe ndërhyrja e KDI-së pas kalimit te afateve ligjore ku thotë se duhet me nënshkrua kontratën që me vazhdua për procedurë na ka shpëtuar sepse ka mundur me vazhdua ende pasi që OSHP ende nuk ka. Sa i përket taksës për biznese, mandatin e kaluar kuvendi i komunës e ka miratuar një rregullore dhe ne jemi te vetëdijshëm dhe i kemi këto shqetësime se ka kodë për veprimtari kryesore dhe ka kode te tjera. Ne i kemi thënë edhe shoqatës se bizneseve por edhe te tjerëve që me ardh me i shlye kodet pasi ato figurojnë edhe ne ARBK por edhe ne ATK, pasi ju e dini që taksa per biznese prodhuese nuk ka hiq mirëpo për biznese tjera ka rregullore që ne i detyrohemi me i qëndrua besnik këtyre dhe mund te i shlyejnë kodet pasi ato ekzistojnë dhe tash taksat vendosen për kode kuptohet për kodin kryesor që është veprimtari kryesor por edhe për kodet alternative apo opsionale që i kanë krijuar gjate regjistrimit . Kështu që ata duhet me ardh edhe me i shlye ato kode edhe lirohen pastaj mirëpo me i majtë kodet edhe me figurua ne regjistër zyrtar atëherë është pikërisht ky kuvend i komunës që mundet me tu drejtua qoftë kryetarit apo drejtorisë përkatëse se pse e keni shkelur rregulloren dhe kjo sigurisht se është vepër penale. Pra kuvendi mund te vendos me i lirue nga taksat sikur që kemi vendos përberja e kaluar e kuvendit për shkak te pandemisë mirëpo ne nuk mund te vendosim që te marrim veprime apo hapa te paligjshëm kur e kemi rregulloren e komunës që qartë i specifikon te gjitha llojet e taksave ne rregulloren që është miratuar ne legjislaturën e kaluar. Ne duhet me patjetër me i taksua ato kode pasi e kundërta ata duhet me i dëshmuar që nuk i kanë funksionale apo nuk ushtrojnë veprimtari dhe nëse deklarojnë se i kanë pasive atëherë duhet ti mbyllin por ne nuk mundemi me akumulua borgje ne

taksa dhe ne te ardhmen me na tërheq vërejtjen seriozisht auditori përmes rekomandimeve. Prandaj ne duhet te tentojmë te ju krijojmë kushte bizneseve që ata te ushtrojnë veprimtari sa me te dobishme dhe ti rrisin kapacitetet, te punësojnë njerëz te ri ne bizneset e tyre por edhe ti paguajnë te gjitha llojet e taksave nëse nuk arrin te dëshmojnë se nuk i përdorin apo nuk i kanë funksionale ato kode për veprimtari jo kryesore. Sa i takon qendrës grumbulluese, ne kemi aplikuar ne ministrin e zhvillimit rajonal dhe po shpresojmë te marrim një lajmë pozitiv pasi kemi pasur edhe kontakte direkte edhe me ministrin ,pasi edhe ata po planifikojnë te na ndihmojnë sa i përket këtij projekti e që duket interesant edhe nga ana e tyre, por siç e dini edhe ju te gjithë pastaj ne do ta kemi si sfidë edhe menaxhimin e kësaj qendre grumbulluese por fillimisht po flasim për fillimin e procesit te ndërtimit te kësaj qendre për grumbullimin dhe magazinimin e produkteve bujqësore ne komunën tonë. Kështu që uroj që te mos jetë e para, pasi me siguri për bujqit tanë do te jetë e leverdishme që me pas edhe qendra tjera te kësaj natyre dhe po besoj që realizimi dhe menaxhimi i këtij projekti do ti jep mundësi qeverisë se Kosovës përkatësisht ministrisë se bujqësisë që me hije me pika te tilla apo qendra për magazinim te prodhimeve bujqësore edhe ne pjesë te tjera te komunës se Rahovecit. Përndryshe vendin e kemi gjete për pikën grumbulluese tek tregu i rrushit dhe projekti me te cilin kemi aplikuar do te jetë me energji diellore dhe nuk do te kemi nevojë me përdor energjinë elektrike dhe do te jetë i standardeve te larta dhe nëse e fitojmë nga ministria e zhvillimit rajonal do te jetë mundësi e mirë që sa me shpejt ta kryejmë këtë objekt dhe normalisht ne kuvend te komunës sigurisht se do ta kërkojmë ndihmën pastaj për sfidën e menaxhimit dhe funksionalizimit dhe te gjitha ato që lidhen ne bashkëpunim me biznese që te ketë një produktivitet dhe te arsyetoj qëllimin investiv ky projekt. Te pyetja e parashtruar nga Burim Krasniqi, mund te ju them se ka pasur një ankesë pasi ka pasur një vendim gjyqësor ku shumen prej 80,000 euro i kanë marr disa punëtor dhe ka një ankesë ne gjykatën e apelit dhe po shpresoj që nuk do te detyrohen me i rikthye mjetet ata që ne mendojmë se nuk kanë te drejtë, kështu që ne presim me u rrëzua ky vendim dhe besoj që pas 3-4 muajve sipas te gjitha gjasave fatkeqësisht vendimi ka me qenë ne favor te komunës, pasi kemi plot argumente dhe ne kemi bërë ankesën dhe po besojmë që sipas avokatit dhe praktikave gjyqësore te kësaj natyre ne do ta fitojmë apo do ta rikthejmë shumen e mjeteve që na kanë marr. Pastaj pyetjes tjetër se sa aktivitete kulturore janë zhvilluar ne shtëpitë e kulturës ne Krushe te Madhe Ratkoc Xerxe dhe Drenoc, e po ashtu është e vërtet se fokusimi me tepër ka qenë ne aktivitete kulturore ne qytet por ka pasur edhe ne Krushe te Madhe kurse këto vende tjera me pak ose hiq, pasi edhe ashtu nuk ka shoqëri kulturore artistike te cilat zhvillojnë aktivitete apo janë me te gjalla kurse ne Krushe te Madhe ka një traditë me t mirë sa i përket aktiviteteve kulturore artistike edhe pse pandemia pak i ka kufizue aktivitetet por kuptohet ne qytet ne shtëpi te kulturës por edhe ne objekte tjera rinore ka pasur aktivitete dhe tash me heqjen e kufizimeve besoj që do te ketë aktivitete me shume. Kurse sa i takon mirëmbajtjes ne kemi kompaninë për mirëmbajtjen e katër objekteve kulturore, ne mundemi me qenë ndoshta te pakënaqur me mirëmbajtjen e këtyre objekteve por e kemi kompaninë për mirëmbajtjen e tyre. Kështu që I sfidoj te gjithë ata që dëshirojnë me u marr me aktivitete kulturore , pasi ne kodin për kulture rini dhe sport nuk është që kemi lanë mangu diçka dhe secilin aplikacion e kemi shqyrtue me vëmendje nga komisioni dhe ka marr mbështetje edhe aktivitete kulturore si shoqatat kulturore artistike si dhe shume aspekte tjera që lidhen me kulturën si botimet dhe promovimet e librave që përpara nuk kanë qenë shume aktive mirëpo tash aplikacionet që na kanë ardhë ne forme te OJQ-ve, ju kemi dhanë mbështetje te madhe, që ndoshta tash mund te kemi vërejtje në mënyrën që i kemi mbështet me shume apo me pak dhe do te kemi vërejtje se sa do te jenë qëndrueshme këto që realisht nuk e dimë pasi që subvencionet edhe ministria e kulturës edhe komunat i kanë një vjeçare pra çdo vit japin subvencione. Edhe pse normalisht ne shohim shume OJQ që aktivizohen gjithmonë ne prag te thirrjes për subvencionim mirëpo kemi disa shoqata apo OJQ që vërtet janë shume funksionale si SHL-Kosova që është jashtëzakonisht aktive dhe shoqata Hareja

por për OJQ-të e tjera gjendja le shume për te dëshiruar edhe pse aktivizohen here pas here mirëpo nuk janë shume aktive dhe nuk kanë qëndrueshmëri ne planin afatgjatë. Pra një strategji e mbështetjes se aktiviteteve kulturore sportive rinore unë besoj që nuk i ka mungue komunës tonë dhe nuk do ti mungoj edhe me tutje. Po ashtu është e vërtet se shumica e vlerave financiare kanë kaluar ne sport dhe ne tash e kemi thirrjen per aplikim dhe sigurisht se do te mundohemi te jemi sa me te barabarte dhe nuk dëshirojmë që dikush me i pas 40,000 euro edhe me pas diskrepanc shume te madhe por maksimumin që do te japim për cilin do klub sportiv apo për cilin do OJQ-ë qoftë rinore kulturore apo sportiv do te jetë maksimum 20,000, pasi që shume mjete financiare kanë shkue ne subvencionimin e sportit dhe kanë ngelur shumë prapa ne kuptimin mbështetjes kultura dhe rinia, kështu që pikërisht tani e kemi një strategji me ndryshe mirëpo gjithashtu e kemi edhe një kufizim tash e tutje sepse nuk kemi te drejt me ju dhanë individëve pa qenë OJQ kurse ministria e kulturës e ka këtë te drejtë që me i subvencionoue edhe individëve kurse neper komuna e kanë kufizue me rregullore, kështu që do ta shqyrtojmë edhe njëherë a ka pasur aktivitete kulturore rinore dhe sportive gjate këtyre katër viteve, unë po besoj që shumicën e aktiviteteve që i keni pae dhe ne rrjete sociale ka pasur vazhdimisht aktivitete që nuk janë ndalue as gjate kohës se pandemisë dhe kemi shembuj që shumica e disiplinave sportive kanë arritur suksese qoftë ne hendboll, futboll futsall basketbollit shahut dhe ju mund ta vërtetoni qoftë edhe nga këto klube sportive se sa e madhe kanë ndihma e komunës rreth subvencionimit te këtyre klubeve dhe sigurisht se do te ju ndihmojmë edhe tash e tutje. Subvencionimi për mekanizma bujqësor janë thirrjet e fundit që janë lëshuar mirëpo ne nuk guxojmë që mos me i dhanë këto.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar kam një replikë të shkurt, që ndoshta nuk isha shume i qartë në fjalimin tim, pasi që nuk jam kundër subvencionimit të klubeve sportive sikur që ju e cekët nga 40,000 ne 20,000 dhe kjo nuk duhet të ndodh, pasi unë jam edhe për me i rritë subvencionet mirëpo qëllimi im kryesor ishte që brenda klubit të ketë edhe një pikë referuese pasi komuna jonë ka shumë talente por vetëm duhet të punohet më shumë dhe të krijohen kushtet nëpër klube të ndryshme apo nëpër shoqëritë kulturore artistike të marrin pjesë dhe të japin kontributin që munden me dhanë. Unë them që ne 4 vitet e kaluar sikur të ishte aplikuar kjo formë ndoshta kish me ndikua në disa raste që rinia që është duke ikur nga këtë, ndoshta kishte me mujt me gjet veten diku dhe të ju krijojmë kushte që me pas mundësi me ushtrua talentin e tij ne këtë vend. Pra, nuk jam kundër subvencionimit të ndonjë klubi më tepër apo më pak pasi aty përcaktohet komisioni që marrin pjesë nëpër gara dhe shpenzimet që kanë gjatë pjesëmarrjes së tyre nëpër gara dhe gjithçka është në rregull. Po ashtu edhe te pjesa e biznesit që e arsyetuet se ata i kanë rendit ja dhjetë aktivitete tjera , krejt në rregull është ju me ju thanë bizneseve që me një shkresë që ata të marrin përgjegjësi se cili është biznesi primar kurse për te tjerat te deklarohen se nuk po funksionojnë me ata të tjerët dhe ne momentin që aktivizojnë me të tjerët atëherë të fillojnë me pagesë. Pra, mendoj se do të ishte më mirë në atë formë pasi që janë lehtësirat më të mëdha sepse përndryshe me shkue ne ARBK qe me u çregjistruet e me plot maltretime të bizneseve nuk kisha preferuar në këtë formë, kështu që ka lehtësira mirëpo vetëm duhet një vullnet më i madh për këtë. Pra, nuk po ju kundërshtoj në formën e subvencionit, por, duhet një përkushtim më i madh te rinia dhe talentet e shumë që ka komuna e jonë.

Burim Krasniqi – Te çështja e subvencionimit të mekanizmave bujqësor, e kam një konsultë apo më mirë një sqarim rreth kësaj, se a ka opinion të zyrës ligjore që është në kuadër të zyrës kryetarit që a mundet me shkua me të njëjtën procedurë tutje e cila ka kaluar mbi dy vite, pra a është ne rregull ne kuptimin procedural dhe ligjor. Pastaj, po pajtohem me Bejtullah Deliun, a ekziston mundësia që kjo rregullore për taksa dhe tarifa me hyj në plotësim ndryshim dhe në konsultim me biznese edhe me grupe te interesit me pa modalitetet qysh mundet me u rregullua sepse edhe me i heqë prej ARBK-së është një procedurë që pas një kohe shfaqet nevoja për veprimtari të ngjashme që ka ne certifikatë te biznesit dhe duhet me shkua prapë me aplikue me qitë, kështu që thjesht me gjete një metodë që përmes rregullores me pa komuna

konkretisht drejtoria e zhvillimit ekonomik me shtie ne plotësim ndryshim rregulloren me grupet e interesit me i dhanë zgjidhjen me te mirë të mundshme në suaza ligjore.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje për te gjithë. Kryetari me herët tha që ka qenë vendimi i kuvendit rreth çështjes se taksave, atëherë po bëhemi edhe ne pjesë e vendimmarrjes pasi flas si njeri i biznesit pasi vërtet bizneset gjendjen ne një gjendje jo te mirë dhe mendoj se asnjëherë si tani nuk ka pasur nevojë me shume pasi vërtet jemi te ngarkuar shume me taksa pastaj nga ATK-ja, kështu që kisha kërkuar nga ju që ndërmerrni diçka në këtë drejtim që me i heqë taksat pasi vërtet është krijuar ngarkesë e madhe për bizneset. Po ashtu edhe sa i përket edhe subvencionimit te ansamblit, si pjesë e ansamblit që jam nga fëmijëria e deri me tash ne ansamblin “Bajram Curri” që edhe ju e vlerësoni shumë dhe ne si ansambël e kemi bo një kërkesë dhe duke pasur parasysh se kemi 54 pjesëtarë aktiv dhe kemi shume shpenzime dhe duke pasur parasysh që kontribut dhënia e madhe pa financiare që do te ishte mirë me na ndihmua ne këtë drejtim pasi kemi shume aktivitete përvjetorë manifestime të shumta që jemi te pranishëm dhe gjithashtu që vazhdimisht e keni përkrah ndoshta edhe pak më shumë se shoqëri tjera, por, tani është rritur edhe kosto e shpenzimeve që kemi, kështu që kemi nevojë edhe për me shume ndihmë nga ana juaj.

Kryetari – Rregullorja për taksat ne biznese është miratuar ne kuvendin e komunës mirëpo nuk do t thotë që asnjëherë nuk mundet me u plotësua dhe me u ndryshua mirëpo sa jam ne dijeni është rregullore unike e cila buron edhe prej rregullores që kujdesen kolegjiunet ne asociacionin e Kosovës dhe tash ne jemi duke e parë kërkesat dhe vine qytetaret po provojnë me i eliminua edhe me i çregjistrua nga veprimtarit sekondare apo veprimtaritë pasive. Pra procedura është shume e thjesht dhe regjistrimi ne ARBK është falas edhe çregjistrimi është falas. Është e vërtet që ne nuk dëshirojmë me ju shtue barrën bizneseve por po ashtu është e vërtet kemi nevojë me qartësua se edhe supozojmë se nëse ne nuk i taksojmë atëherë ne te shumtën e rasteve atëherë ATK i kanë ne sistem te gjitha dhe nëse nuk e bëjmë këtë punë bashke me bizneset ne koordinim pasi kam pasur takim edhe me kryetarin e shoqatës se bizneseve z. Fadil Sylka edhe i kemi orientua që te provojnë me i lehtësua punën vetes dhe ne me ju krijuar kushtet që me i largue kodet pasi krejt formale i kanë mirëpo nuk i ushtrojnë ato veprimtari. Pra duhet me i arsyetua dhe me i vërtetua ato që mos me u taksue. Kështu që me i heqë te gjitha taksat nga bineet atëherë do te kemi problem si komunë se si me i realizue te ardhurat, pasi ky kuvend i komunën ne legjislaturën e kohës se Idriz Vehapi shumica e taksave për biznese janë hequr gjithashtu edhe unë ne fillim te mandatit tim ne vitin 2018 kemi hequr dhe tash kanë mbet te gjitha ato biznese që nuk janë prodhuese po që realisht nuk janë taksa te mëdha . Ne kemi provuar vitin e kaluar dhe gjithashtu ne vitin 2020 përmes kuvendit te komunës i kemi lehtësua dhe i kemi falë bizneset per shkak te pandemisë dhe tash duhet te shohim si do te rrjedh situata, përndryshe kish me qenë interesant që me pas ndonjë informatë se cilat biznese janë financuar nga qeveria e Kosovës prej 236 milion euro. Po ashtu ne pyetjen e parashtruar nga Bejtullah Deliu rreth sponsorizimit, pasi që unë jam edhe kundër formës tradicionale te sponsorizimit apo te subvencionimit te OJQ-ve. Pra ne vërtet e kemi gjetur këtë forme mirëpo krejt çka kemi bo ne veç ju kemi shtuar vlerat pasi është shtuar buxheti për veprimtarit apo aplikacionet që ne bazë te programit kanë aplikuar OJQ-të, përndryshe nuk mendoj se është forma me e mirë e subvencionimit dhe jam për me ndryshua çasjen pasi kemi OJQ- që aktivizohen ne kohen kur hapen thirrje për subvencione por kemi edhe veprimtari që nuk munden me regjistrua OJQ-në dhe individ shume te zotë dhe shume talente te zotë që merren me artizanale që për shkak se nuk ka OJQ nuk mundet me shfrytëzue te drejtën për me marr mbështetje. Pra unë jam që klubet sportive parasë gjithash me u shndërrua ne shoqëri aksionare siç ndodh neper komuna tjera dhe është e vetmja komuna e Rahovecit që jep ketë shume te madhe për sport dhe nuk do te thotë që ne jemi kundër kësaj dhe ne jemi edhe për me rritë por e vetmja perspektivë për sportin ne Rahovec si gjithandej ne Kosovë është shndërrimi Klubeve sportive nga OJQ ne shoqëri aksionare ne mënyre që me u shfrytëzue pastaj e drejta që kep ligji për sponsorizimin e

sportit me përqindjen e tatimit në fitim. Pra komunat me të mëdha të Republikës së Kosovës që kanë buxhet dhe subvencione shumë do të shihni sa pak e ndihmojnë sportin për shkak se janë kthyer në shoqëri aksionare. I kam kërkuar edhe drejtorit të kulturës rinise dhe sportit z. Afrim Dina që të ftojë klubet dhe me ju dhanë këtë mesazh pasi pothuajse të gjitha klubet në të gjitha komunat në Kosovë janë të shndërruara në shoqëri aksionare, kështu që në jemi krenar me klubet tona mirëpo këto para nga subvencionet nuk është qepo ju shërbejnë për me realizue ndoshta edhe elementet e projektit mbi bazën të cilave kanë aplikuar në komunë, përndryshe secila OJQ aplikon me një projekt të caktuar dhe subvencionet jepen çdo vit dhe sigurisht se jam për me i rrit subvencionet në sport kulturë edhe në rini edhe këto subvencione me u kthye në mekanizma dhe mbështetës për rini kulturë sport dhe për elemente të trashëgimisë e plot sene tjera që e kemi një komision të monitorimit pasi deri në një masë të caktuar kemi të drejtë me kërkua prej OJQ-ve mirëpo jo me ndërhyje në OJQ. Pra mënyrën se si i shpenzojnë ata neve na tregojnë përmes një raporti që janë të detyruar me sjell në drejtorin e kulturës rinise dhe sportit dhe i cili raport pastaj jepet edhe si informatë në kuvend. Po ashtu edhe të ansambli Bajram Curri që unë e vlerësoj shumë pasi na bën krenar shumë herë jo vetëm neve si komunë, kështu që tash do ta bëjmë aneksin edhe për nevojat të ansambli por duhet me pas edhe program pasi nëse kanë aplikuar tash duhet ta paraqesin se çfarë aktivitete kanë me zhvillue dhe në cilën fazë kanë me zhvillue në mënyrë që në me pas të drejtën që në bazë të vlerësimit që i bëhet projektit të aplikacionit që me pas mundësi me i shtue vlerat dhe jam për me ja shtue vlerat. Pastaj të pyetja e parashtruar nga Burim Krasniqi rreth mekanizmave bujqësor, unë mund të ju them se janë 5 operator kanë prit me i nënshkruar kontratat para gjashtë muajve por një operator për njërin lotë është ankuar dhe procedura ka zgjatur pasi edhe OSHP-ja nuk ekziston. Kështu që KDI-ja ka ndërhyje dhe i ka zhblllokue komunat dhe plot organizata buxhetore për shkak se janë tejkaluar të gjitha afatet ligjore sigurisht edhe të ankimimit pasi nuk kemi OSHP, kështu që në kemi shkuar në procedurë të lidhjes së kontratës dhe procedura e lidhjes së kontratës është plotësisht e bazuar në ligj për shkak se ka shkuar mirë mirëpo vetëm se ka pas vonesë dhe në tash jemi të detyruar bashkë me operatorin si autoritet kontraktues me kërkua nga operator që me i zbatua kontratat. Pra javën tjetër pritet me pas shpërndarje pasi edhe ashtu jemi vonua dhe për këtë jam shumë i vetëdijshëm për shkak se fermerët i kanë prit shumë me herët mirëpo ashtu ka shkue procesi siç e dini edhe ju vet, kështu që nga informacioni që mora nga drejtori i bujqësisë po presin me shumë se 200 fermer me participue dhe me i marr mekanizmat bujqësor. Po ashtu edhe lista e përfituesve për vitin 2021 do të del shumë shpejt edhe ndoshta mënyrën e subvencionimit ndaj fermerëve do ta kemi me ndryshe, pasi kemi pasur mënyrën e financimit 80% me 20% që mundemi me hyje edhe në in pute bujqësore edhe në forma tjera të subvencionimit që fermerët me pas me të lehtë përkundër këtyre vështirësive të mëdha dhe rritje të çmimeve në situatën që po e kalojmë. Faleminderit të gjithëve për kontributin tuaj, kështu që kam kërkuar edhe materialin nga drejtori i bujqësisë me shifrën e sakta të subvencionimit të OJQ-ve nga viti 2015 deri në vitin 2021, kështu që ka dallime shumë të mëdha në kuptimin pozitiv pasi nga viti në vite janë rrit subvencionet në kulturë rini sport por edhe në bujqësi kuptohet që shpresojmë me u rrit edhe me shumë në të ardhmen.

Hasan Përboqi – Përsëritje kryetar, kryesues, drejtor të drejtorive, kolege asamblistë, media, monitorues të seancës dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë kisha dashtë me u ndal të thirrja për subvencione që është hapur nga drejtorja për kulturë rini dhe sport dhe me u ndërlidh me atë që është diskutuar deri tash. Të gjithë asamblistët janë përfaqësues të qytetareve dhe po besoj që duhet të jemi të drejtë para tyre. Duhet me pas parasysh se ku ka qenë sporti para se me marr mandatin Smajl Latifi para vitit 2018 dhe ku është tash. S i një adhurues i sportit që i ndjek pothuajse të gjitha klubet sportive të Rahovecit, kisha dashtë me saarue që para vitit 2018 në qytet kanë funksionuar vetëm dy klube sportive, si klubi i futbollit ka qenë në rangun me të ultë në Kosovë e po ashtu edhe klubi i basketbollit ka qenë para

shuarjes dhe te gjithë ne që kemi qenë ne ekzekutiv se ne çfarë gjendje ka qenë klubi i basketbollit. Pra duhet te jeni ne dijeni se subvencionimi me i madhe ne histori te sportit ne Rahovec ka ndodh me përfundimin e palestrës që la përfundua ne mandatin e kryetarit Smajl Latifi dhe te gjithë e dimë se nuk ka ekzistuar asnjë klub tjetër sportiv përpos basketbollit dhe futbollit, kështu me ndërtimin e palestrës kemi edhe aktivizimin e shume klubeve dhe shkollave që aktivitetin e tyre e zhvillojnë ne palestër dhe gjithashtu është kënaqësi shume e madhe që komuna e përkrah një shkolle te basketbollit me te gjitha gjeneratat që na bëjnë krenar çdo ditë e me shume dhe sjellin shume suksese. Kështu që nuk duhet te shohim vetëm zi pasi klubet sportive ne Rahovec janë te suksesshme dhe kjo falë mbështetjes që kanë marr prej komunës dhe subvencioneve direkte që kanë shkuar aty. E dimë shume mirë se ku ka qenë sporti ne komunën e Rahovecit para vitit 2018 dhe te gjithë kanë premtua për përfundimin e palestrës por vetëm ne vitin 2018 me kryetarin Smajl Latifi me sfidat që u përball që me përfundua palestrën dhe me aktivizua që me u ndie krenar i gjithë qyteti i Rahovecit me klubet që i kemi. Kështu që unë kam një kërkesë për kryetarin drejtorin e kulturës rinis dhe sportit e ndoshta edhe për zyrën ligjore, që si asamblast kërkoj që a ka ndonjë mundësi ligjore që ne si kuvend me ndihmua me shume me rrit shumen financiare për subvencionimin e klubeve pasi vërtet kanë nevojë dhe është e pamjaftueshme shuma që marrin, pasi që nga aktivizimi i palestrës është ngjallë jeta sportive ne qytetin e Rahovecit, kur dy here kemi pasur mundësi që te organizojmë Final four ne palestrën e qytetit dhe jo vetëm Kosova por te gjitha shtetet e rajonit e kanë përmendur organizimin dhe palestrën moderne që është ndërtuar.

Bejtullah Deliu – Si duket kolegu asamblast është emocionuar pak në këtë pikë dhe e mbron kryetarin kurse pak me herët kryetari e tha që jemi keqkuptua kurse ky tash del edhe komenton krejt diçka tjetër. Ne mesa duket me herët veç u kuptuam me kryetarin se ku ishte qëllimi jo te mos subvencionimi apo ankesa nuk ishte që pak po subvencionohen por forma e gabuar që mund te shtohet diçka, pra. këtu ishte qëllimi. Pastaj nëse personi ne fjalë e thotë se e do shumë sportin, atëherë unë i them se je shumë gabim që para vitit 2018 nuk ka pasur sport ku ne hendboll kanë qene dy ekipe pastaj ne basketboll dy ekipe, në futboll dy ekipe pastaj ka pasur ekip basketbolli te femrave dhe ekip hendbolli te femrave. Kështu që ju them se nuk qenke ne dijeni aspak se çka ka ndodhur para vitit 2018 në sportin e Rahovecit, mirëpo unë ju garantoj që nëse ju ktheheni edhe merreni pak më shumë me sport ju them se ka pasur shumë me tepër ekipe te suksesshme para vitit 2018 se sa që është tash, kështu që ju them se merreni me gjëra faktike dhe mundeni me kundërshtua por unë ju garantoj se vet jam marr me sport pasi që kam luajtur hendboll, qe ndoshta ju ndoshta jeni dashamir me sport por unë jam ballafaqua direkt aty pasi gati shumica e disiplinave sportive ka pasur ka 2 ekipe edhe te suksesshme dhe nuk është aspak e vërtet që nuk ka pasur ekipe sportive para vitit 2018.

Merisa Sharku – Përsëndetje për te gjithë. Muajin që e lëm pas, isha pjesë e disa eventeve te mbajtura kushtuar gruas e përfshirë këtu edhe formimin e grupit te ri joformal te grave ne komunën tonë. Kështu që një prej arsyeve kryesore që jam unë këtu është të qënurit grua dhe dëshirës që zëri i gruas ne komunën tonë te dëgjohet dhe pozita e saj te ngrihet e te forcohet. Ditëve te fundit po dëgjojmë që për gjysmën e popullsisë te komunës tonë që janë burra e që merren me bujqësi po shpërndahen e po subvencionohen me mekanizma bujqësor. Unë mendoj se kjo është shumë mirë mirëpo çka po ndodh me gjysmën tjetër te popullsisë se Rahovecit e që janë gra edhe që ne komunën tonë nuk është që mbesin prapa me punë e me kontribut si ne zhvillimin e komunës e ashtu edhe ne mbajtjen e familjes dhe kur do te merren vendime që këto gra te subvencionohen dhe bizneset e tyre të zhvillohen akoma me shume që te mos punojnë individualisht ne shtëpitë e tyre dhe ne kushte edhe jo te përshtatshme për punë. Po ashtu ditë me parë bashkë me kolegë asamblastë me përfaqësues te zyrës për barazi gjinore me përfaqësues te shoqatave dhe përfaqësues te OSBE-së formuam grupin jo formal te grave ne komunën tonë, kështu që presim përkrahje

nga kryetari e komuna për te ecur përpara ne si grup, gjithmonë kjo me arsyen që gruaja te ngrihet ne detyre. Unë besoj që gratë ne komunën tonë janë shume të afta dhe mund të jenë shumë të suksesshme në udhëheqje dhe nuk e di kryetari a mendon kështu si unë, pak po dyshoj jo me hamendje por duke e parë realitetin. Në mandatin e kaluar ne pozita udhëheqëse përkatësisht në drejtori kanë qenë vetëm dy drejtoresha femra edhe pse gjate fushatës kryetari ka premtuar që ka me rrit numrin e drejtoreshave femra por prape ka vazhduar përsëri vetëm me dy drejtoresha femra. Kështu që unë e pyes kryetarin, që ne komunën tonë nuk ka gra te afat që mos me ju besua edhe ndonjë drejtori apo ndonjë pozitë tjetër udhëheqëse.

Kryetari – Unë po mendoj se jemi keqkuptuar pothuajse te gjithë por sidoqoftë përrurimi i palestrës e ka dinamizue jetën sportive ne qytet dhe gjithashtu është shume e vërtet se klubet sportive nuk janë mbështetur asnjëherë me shume se ne 4 vjeçarin që shkon dhe sigurisht se do te mbështeten përsëri edhe ne këtë mandat. Po ashtu është shume e vërtet se klubi basketbollit Rahoveci dhe klubi i futbollit Rahoveci janë mbështetur shume pak kurse klubet tjera shume pak janë mbështetur apo me than aspak, po flasim para vitit 2018. Sigurisht që Rahoveci ka traditë ne sport dhe ka plot trofe te fituar ne te kaluarën dhe madje edhe para luftës edhe ne kohen e ish Jugosllavisë që ka pasur ne te gjitha aspektet ka pasur një traditë pozitive dhe suksese ne sport ne shume disiplina. Po ashtu e dëgjova me vëmendje edhe kërkesën e Merisës , që edhe dëshira e jonë është me pas drejtoresha neper drejtori te komunës se Rahovecit mirëpo unë mbaj mend kur e kam gjet me vetëm një drejtoresh ne vitin 2018 kurse tash i kemi dy drejtoresha ne këtë mandatë. E përgëzoj aktivitetin me rastin e themelimit te grupit joformal te grave që mendoj se është grup shume i rëndësishëm edhe ne pikëpamje te përfaqësimit por edhe te profilit por edhe ne plot aspekte që ne fakt unë ju siguroj mbështetje por që duhet me qenë te artikuluara ne kërkesa dhe shqetësimet që i keni por gjithsesi është shume e rëndësishme që grupi jo formal i grave nëse ka një rol aktiv dhe kryen aktivitete atëherë pse jo komuna edhe me lejen e kuvendit komunal dhe unë si kryetar i komunës po besoj që nuk është askush kundër. Çdo aplikacion që ka qenë për gratë fermerë që kanë aplikuar asnjëherë asnjë nuk është refuzuar dhe nuk besoj që do te refuzohen, mirëpo tash varet pasi kjo është edhe një kriter që është vendosur edhe ne komunë edhe ne ministri që kur aplikon një vajzë apo një grua ka poena me shume. Kështu që ne i mirëpresim dhe ju apeloj edhe nga këtu se sa here te ka thirrje qoftë për bujqësi apo edhe për aktivitete tjera që lidhen me fuqizimin e rolit te gruas ne i inkurajojmë dhe i bëjmë thirrje që te aplikojnë. Unë mendoj se ka plot gra te zonja ne komunën e Rahovecit e që mund ta marrim si shembull zonjën Sadbere Osa një grua shume e zonja dhe shume e suksesshme ne biznes, e plot gra te tjera te suksesshme ne qytet e që e kemi edhe një grua ne fshatin Zatriq që merret me qëndisjen e flamujve, veshjeve kombëtare tradicionale dhe sa here ka aplikuar ajo çdo her i kemi ndihmuar dhe jemi te interesuar që kushdo që aplikojnë me ju ndihmua qoftë kulturë rini sport por edhe ne bujqësi e thirrje tjera që hapen nga komuna ju them publikisht do ti përkrahim vazhdimisht jo për faktin se përbejnë gjysmën e popullsisë por edhe për faktin se është e nevojshme edhe barazia gjinore.

Merisa Sharku – Un mendoj se duhet me u krijua linja ashtu siç është bujqësi pasi e dimë se nuk ka edhe shumë femra që merren me bujqësi, kështu që unë mendoj që duhet me i krijua një linjë e re me ato zanate që merren gratë dhe kur e dimë që ne Rahovec merren me artizanate atëherë duhet me u krijua linjë e subvencionimit me marr mjete për punët që i kryejnë për ato zanate.

Kryetari - Është një organizatë gjermane Held që ne kemi fitue një grant dhe grat[e komunës tonë mund te përqendrohen që te aplikojnë. Kemi edhe organizata ndërkombëtare që e kanë te precizuar si kriter që nëse aplikacioni plotësohet nga gjinia femërore atëherë me lehtë e kanë mundësinë me perfitua. Por gjithsesi grupi joformal i grave do te mbështetet dhe nuk e di a kemi mundësi me sigurua kod t veçantë pasi nuk varet nga ne dhe nuk varet as prej kuvendit te komunës sepse i ka disa kriteret ministria e financave që i

lejon apo nuk i lejon ndërsa sa i takon çështjes se rritjes se subvencioneve edhe këtë vite nuk do të mundemi mirëpo vitin e ardhshëm ka gjasë që do të kemi me i rrit subvencionet pasi disa kode që kanë qenë përpara nuk po i lejon programi i ministrisë se financave edhe duhet me i rrit kuptohet në koordinim me departamentin për buxhet në ministrinë e financave të Republikës së Kosovës. Pra shumëçka varet nga ministria e financave nëse na lejohet hapja e kodit për me buxhetue grupin jo formal të grave dhe gjithësesi në jemi dakord por që po besoj që edhe të njëjtin mendim ka edhe kuvendi. Po ashtu nëse na lejohet edhe hapja e kodit për rini që është kodë i veçantë në do të jemi pro kësaj pasi veç thuhet se ja dy komuna e kanë si komuna Prishtinës apo edhe Prizrenit që e kanë futur shume herët mirëpo komunat e mesme e kanë shume problem me futë në program ose kode që lidhen qoftë me buxhetimin e rinisë direkt apo edhe të grave direkt, kështu që do të shohim për vitin 2023 pasi për këtë vit nuk do të kemi mundësi.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar për të gjitha sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

Kryesuesi – Fillimisht kisha kërkuar nga shefat e grupeve nëse jeni koordinua paraprakisht nëse keni propozime mundeni me vërtetua me ngritje të dorës. Kështu që kemi dy propozime, njeri është nga AAK-ja dhe njeri nga PDK-ja.

Besa Bytyqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblastë dhe gjithë të pranishmit. Grupi i aleancës për ardhmërinë e Kosovës për këtë komision e propozon Doruntina Sopjani.

Bejtullah Deliu – Grupi i PDK-së e propozon Armir Vuçitërna.

Kryesuesi – Atëherë dy anëtarët nga kuvendi komunal në këtë komision janë Doruntina Sopjani nga AAK-ja dhe Armir Vuçitërna nga PDK-ja, kurse dy anëtar të tjerë janë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtar vjen nga sektori jo qeveritar të cilët do të emërohen pas seancës apo ditëve në vazhdim. Atëherë e vendosim në votim komisionin me këtë përbërje prej dy anëtarëve. Me shumicë të votave miratohet propozim vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Kryesuesi – Pra bashkë me materialin e kësaj pike e keni të bashkangjitur e keni edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të cilat rekomandime kanë ardhur nga anëtarët e kuvendit ku të pika e katërt e kemi rekomandimin për shqyrtimin e draft rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare ku është kërkuar që të largohet pika 1.4 neni 5.

Erhan Morina – I nderuar kryetar, kryesues, drejtor të drejtorive, anëtar të kuvendit, media dhe gjithë të pranishmit në sallë. Me kërkesë të auditorit të jashtëm dhe me propozim të drejtorisë të Ekonomisë Zhvillim dhe Turizëm është propozuar dhe hartuar projekt rregullorja menaxhimi i pasurisë jo financiare dhe inventari i papërdorshëm i komunës. Kjo rregullore është punuar nga një grup punues prej 9 anëtarëve, ky dokument ka qenë në konsultim publik në webfaqen zyrtare të komunës dhe në platformën për konsultime publike nga data 26.01.2022 deri 26.02.2022. Po ashtu me datë 09.02.2022 është mbajtur edhe konsultimi publik me qytetaret në sallën e kuvendit komunal ku në këtë konsultim publik janë dhënë 5 komente dhe nga këto komente nuk kanë mundur të inkorporohen në këtë rregullore pasi që ky projekt çështjet e cekura në këtë rregullore. Ky projekt rregullore përbëhet prej 13 neneve ku përmes këtyre neneve precizohet qartë mënyra e menaxhimit dhe e trajtimit të aseteve komunale. Me konkretisht kjo rregullore përcakton procedurat e detajuara të menaxhimit të pasurisë jo financiare të komunës e në veçanti ka të bëjë me menaxhimin e inventarit të pa përdorshëm të komunës pastaj zhvlerësimin e pasurisë jo financiare,

bartja e të hyrave nga zyrat e komunës deri te depoja, detyrat e komisionit përgjegjës, ruajtjen e aseteve jo financiare, lëvizjen tjetërsimin shitjen asgjësimin si dhe raportimin me qëllim të menaxhimit sa më efikas dhe transparent. Me kërkesë të anëtarëve të KPF-së pasi ka qenë kërkesë e tyre që të ndryshohet apo të hiqet nga neni 5 pika 1.4 ku ceket se komisioni në këto aktivitete mund të i kryej edhe jashtë orarit të punës të rregullt të punës dhe paguhet sipas legjislacionit dhe kjo kërkesë ka qenë kryesisht e shefit të LDK-së z. Burim Krasniqi që të largohet nga ky nenë. Për me gjerësisht, materialin e keni përpara, kështu që kërkoj nga anëtarët e kuvendit që ta votojnë këtë projekt rregullore.

Burim Krasniqi – Kur mbahet seanca e KPF-së, ajo mbahet për me i dhanë një filtër dokumentit para se me ardh në mbledhje të Kuvendit, kështu që po besoj që kërkesat e KPF-së duhet me u përfill pak më drejtë, pasi rregullorja ka ardhë e njëjta e gjitha me atë që është diskutuar në KPF, asnjë kërkesë në mbledhje të KPF-së nuk është marr parasysh. Po ashtu të neni 7, menagjimi me (g j) e keni dhe jo me (xh) ashtu që duhet të jetë, kështu që këto gabime teknike mendoj që nuk duhet kuvendi të merret me këto ndryshime. Po ashtu rregullorja duhet të mbështetet po ashtu të rregullorja 02/2013 duhet me pas me të qartë të përfshin, pasi e shoh që paskan punuar 9 anëtar edhe po thuani në procedurë të detajuar. Unë po mendoj që nuk e shoh të arsyeshme me punue 9 anëtar për 13 nene dhe nuk është e detajuar. Unë e kam një vërejtje përpos të pika 1.4, neni 5 të neni 7 me u përmirësua në xh, pastaj neni 8 dhurimi transferimi shitja asgjësimi i pasurisë jo financiare duhet me qenë me i specifikun sepse është shumë më e mangët se sa rregullorja e ministrisë së financave. Pastaj të neni 10, rregullat përfundimtare për çështje që nuk janë të rregulluar me këtë rregullore dhe në kundërshtim me të, unë mendoj se ska kurrfarë kundërshtimi pasi mendoj se është termë i papranueshëm në rregullore. Të ndryshimet dhe plotësimet e rregullores neni 11, thotë kjo rregullore mund të plotësohet dhe ndryshohet në çdo kohë nga kuvendi i komunës në përputhje me nevojat ligjore. Mendoj se kjo është çështje e ditur dhe nuk ka nevojë me ekzistua si nën pasi ky është vlerësim i imi personal dhe i grupit të asamblistëve të LDK-së, kështu që po konsideroj se këtë rregullore është mirë me marr edhe njëherë me e rirregullua dhe me bo me të detajuar edhe me sjellë për miratim përndryshe e shoh shumë më të mangët se sa rregullorja 09/2013 e Republikës së Kosovës së Ministrisë së Financave. E kuptoj se kjo është rregullore komunale dhe gjithashtu e kuptoj se rregullorja e ministrisë së financave e përfshin edhe asetet e institucioneve tjera si Kost, Kek etj por se paku këtë rregullore pikat që ju takojnë komunave me i përfshi që me qenë me e plotësuar. E kuptoj që kjo e heq një obligim të rekomandimeve të dala në raportin e auditorit, por, nuk bën zgjidhje, apo me ja shtuar një nenë që çdo çështje që nuk është e rregulluar me këtë rregullore zbatohet rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kështu që e kemi vlerësuar si të mangët në si grup i asamblistëve të LDK-së. Pra kërkoj mirëkuptimin që kjo rregullore me u plotësua para se me ardhë në votim.

Kryetari – Unë besoj që rekomandimet në kuvend përcillen nga KPF-ja dhe në konsultë me shefin e sektorit të kuvendit nuk guxojmë me i prek dokumentet por rekomandimet kemi të drejtë dhe duhet ti përfillim sepse çdo gjë vendoset në kuvend. Sa i takon rregullores apo projekt rregullore që po besoj që drejtori Erhani e ka të qartë dhe e lexoj rekomandimin e KPF-së kurse sa i takon mangësive në kemi një standard të hartimit të rregulloreve që nuk e bëjmë vetëm komuna jonë dhe nuk vendos asnjë asamblist për formatin e rregulloreve se si bëhen por vendos asociacioni i komunave të Kosovës që janë rregullore unike për komunat. Arsyeja se pse e kemi formuar grupin punues prej 9 anëtarëve, është pasi kështu e kërkon procedura, përndryshe materiali është unik neper komuna të Kosovës kur behet fjalë për rregulloret e tilla, pasi ajo që nuk është e paraparë në këtë rregullore atëherë është rregullorja e Ministrisë së Financave, që ska nevojë me u përmend nëse është në kundërshtim me rregulloren atëherë nuk ka nevojë me u përmend edhe rregullorja e ministrisë së financave. Por ka nevojë me u përmend se vetëm kuvendi i komunës mundet me bo plotësim nevojën për plotësim ndryshime por gjithashtu edhe nevojën për përmbyshjen të cilësdo

rregullore që e miraton vetë. Kështu që unë mendoj që me këto vërejtje që ju i dhatë që mundemi me i akomodue kur te regjistroheshen ne procesverbal, rregullorja do te ishte mirë me shkue jo për shkak se ka kërkuar auditori por për shkak se ne e kemi obligim me pas një trajtim ma me respekt te aseteve te papërdorshme ose inventarit te papërdorshëm te komunës se Rahovecit. Mendoj se kjo rregullore i precizon ato që duhet me i precizue ndërsa detajet janë ne domenin e përgjegjësive te komisionit kurse për vlerësimin e këtyre situatave e po ashtu edhe te çështjeve te ankandit se çka duhet te hidhet ne ankand pastaj si shkojnë procedurat e po ashtu miratimin për ankande e merr edhe nga kuvendi i komunës, kështu që po mendoj se nuk është e mangët mund te plotësohet me ato vërejtje që i dhatë dhe do te ishte mirë me kalue sa me shpejt që është e mundur dhe me marr miratimin e kuvendit te komunës. Pra do te ishte mirë me pas një rregullore që është unike për komunat nga asociacioni i komunave pasi ne marrim orientimin prej kolegjiuemeve te asociacioneve te komunave pasi ne atë asociacion ka kolegjiueme për arsim, shëndetësi, për shërbime publike, ekonomi, turizëm, pra ata i bëjnë disa rregullore unike që me pastaj i përcjellin neper komuna dhe pastaj ne me ato rregullore shërbehem sepse ato bazohen ne ligjet që janë te aplikueshme ne fuqi. Pra e ftojë për mirëkuptim Burimin dhe gjithashtu ftojë te gjithë kuvendarët që ta miratojmë me gjitha ato vërejtje që u bënë kuptohet do te jetë mirë me u miratue rregullorja nga kuvendi i komunës.

Artan Asllani – Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin, drejtorët e drejtorive dhe gjithë koleget asamblistë. Deshta te kontribuoj pak ne këtë pikë te rendit te ditës, pasi që jam marr direkt ne regjistrimin e aseteve gjate mandatit si drejtor i ekonomisë, është fatbardhësisht një punë e mirë pasi që nga viti 2018 komuna e Rahovecit tashme ka një pasqyre reale dhe te qartë rreth pasurisë komunale qoftë në vlerën 1000 euro apo qoftë mbi vlerën 1000 euro dhe gjëra tjera. Ka qenë rekomandim i auditorit te jashtëm që kjo rregullore ete bëhet nga kuvendi i komunës se Rahovecit apo edhe nga drejtoria e ekonomisë. Kështu që unë kisha pas me thanë që kjo rregullore që është sjellë ne kuvend është mjaft mirë, pasi edhe ne vlera te mëdha drejtoria përkatëse duhet te bazohet ne rregulloren që është e përcaktuar nga ministria e financave. Kjo me shume ka te bëjë me disa asete që janë jashtë përdorimit dhe që nuk kemi nevojë edhe me marr përgjigje nga ministria e financave mirëpo që ju jep lehtësirë komisioneve që bëhen përsëri nga ekzekutivi dhe zhvillohen procedura tjera ne ankand sipas ankandit oferta me e mirë edhe i merr gjësente te ndryshme.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e katërt te rendit te ditës, pa pikën 1.4 te nenit 5 sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa. Konstatoj se me shumicë te votave miratohet pika e katërt e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale (inventari) për vitin 2021.

Erhan Morina – I nderuar kryetar, kryesues, drejtor të drejtorive, anëtar te kuvendit, media dhe gjithë ju te pranishëm. Drejtoria për ekonomi zhvillim dhe turizëm ka përpiluar këtë pikë te rendit te ditës si informatë për menaxhimin e aseteve jo financiare te komunës se Rahovecit. Në këtë pikë te rendit te ditës përshkruhet se si janë menaxhuar asetet kapitale mbi 1000 euro dhe nen 1000 euro ne komunën e Rahovecit për vitin 2021. Kjo pikë informuese praktikohet te prezantohet çdo vit me qellim te transparencës dhe llogaridhënies mbi menaxhimin e aseteve komunale nga ana e qeverisjes lokale. Ne vitin 2021 me kërkesë te Kryetarit Smalt Latifi janë formuar katër komisione te cilat kanë qenë përgjegjëse për regjistrimin inventarizimin tjetërsimin dhe asgjësimin e pasurive jo financiare. Ne fund te vitit 2021 komisioni për inventarizim ka kryer inventarizimin e pasurive jo financiare ne administratë arsim QKMF dhe objekte përcjellëse, ku ne raportin përfundimtar janë konstatuar se janë gjithsej 219 asete jashtë përdorimit. Komisioni i regjistrimit ka përfunduar regjistrimet dhe ka evidentuar ne administratë komunale objekte kulturore dhe sportive 7223 asete , ku ne shkolla ka evidentuar 21,035 asete kurse ne QKMF QMF dhe AMF janë gjithsej 1823 asete. Po ashtu komisioni për asgjësim gjate vitit 2021 ka asgjësuar 34 asete, kështu që i keni te paraqitura ne mënyrë tabelore mbi 1000 euro dhe nen 1000 euro. Regjistrimet e aseteve kapitale mbi 1000 euro kanë qenë 250 asete ne vlerë prej 5,511,030 euro kurse regjistrimet me pak se 1000 euro kanë qenë 711 asete

me vlerë totale 98,771 euro. Pra gjithsej regjistrimet ne vitin 2021 kanë qenë 5,609,801 euro. Gjithashtu vlen te ceket se nen vlerën 1000 euro janë kryesisht asete te imta siç janë karrika, tavolina, kompjuter e pajisje tjera. Po ashtu ne tabelën 2, kemi asetet me vlerë me pas 1000 euro sipas nën kodeve ku përfshihen pajisje teknologjike, informative, pajisje mjekësore, pajisje te tjera mobile ku kapin vlerën rreth 837,206 euro ndërsa ne tabelën 3 mund regjistrimet ne vlerën mbi 1000 euro sipas klasave te pasurisë se regjistruar ne programin SMFK, ku kryesisht janë të përfshira te gjitha zërat e aseteve komunale duke përfshira objekte arsimore, objekte sportive, kulturore, veturat, pajisjet, trotuaret, rrugët, etj që kapin vlerën e aseteve komunale 136,258,977 euro. Po ashtu ne KPF ka qenë kërkesë e anëtareve te KPF –se te jepet shpjegim me numrin rendor 9 ku ka qene e emëruar si kamion ku faktikisht ne këtë pozicion janë dy kamion zjarrfikës, ku njeri përfshin vlerën 24,000 euro kurse tjetri përfshin vlerën 3839 euro. Kanë qenë te përfshirë ne një zë ne bilanc por për shkak se sistemi i përmbledh te gjitha te dhënat ne një kod kurse këtu janë te specifikuara me numrin e IT-së te secilit asetë, kështu që për sqarim janë dy asete dy kamion te zjarrfikësve. Pra pasuria totale jo financiare siç e ceka me herët ne vitin 2021 ka qenë 136,258,977 euro. Ky është një prezantim se i përket aseteve jo financiare te komunës se Rahovecit, gjithashtu para jush keni edhe materialin siç është përshkruar me detajisht për te gjitha klasat e pasurive komunale.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e kalojmë si te tillë pasi është vetëm si informatë. Kalojmë ne pikën e gjashtë te rendit te ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Draft-strategjisë komunale për informim dhe komunikim 2022-2025.

Fatmir Iska – Faleminderit i nderuar kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, anëtar te kuvendit dhe gjithë të pranishmit. Në mungesë të zyrtarit për informim, si bartës i këtij dokumenti strategjik komunal për komunikim dhe informim, pasi të gjitha procedurat janë kryer, konsultimet janë mbajtur dhe po ashtu komentet që janë dhanë janë inkorporu ne këtë strategji, kështu që gjithë materialin e strategjisë e keni para vetes, kështu që nëse ka dikush diçka me shtu apo me heqë mund ti diskutoni dhe me pastaj ne do ti shohim ato te arsyeshmet dhe do ti inkorporojmë ne këtë strategji.

Burim Krasniqi – Ne si dokument mundemi me aprovu pa ndonjë problem pasi është strategji e komunës per komunikim me qytetaret mirëpo nuk e di a është çështje komunikimi me qytetarin me qëllimin që me qenë komunë e hapur ne kuptimin e informimit apo për komunikimin e brendshëm te komunës. Kur e them këtë e kemi te rasti i spot analizës, p.sh. përparësitë aktuale të komunikimit ku pika 1 thotë se praktikat pozitive të komunikimit të brendshëm dhe marrëdhënieve me media. Por, kjo bjen në kundërshtim me pjesën e dobësive aktuale të komunikimit ku thotë mosnjohja e duhur e qytetarëve mbi besueshmërinë e lajmeve që plasohen nga mediat online, a është praktikë e mirë apo nuk është. Pastaj, shtimi kapaciteteve njerëzore ne zyrën për informim që është menduar si mundësi për rritjen e kapacitetit, a ka hapësirë buxhetore për me marr zyrtar të rregullt apo është planifikuar vetëm për me marr shërbime me kontratë për shërbime te veçanta qysh ka pasur raste. Te rreziqet e pash si diçka jo korrekte ku thotë tendenca ne rritje e qytetareve që informimi përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi, që une mendoj se kjo është paragjykim për mediat pasi nëse dikush e sheh si rrezik te mundshëm dhe qytetari i beson me shume një media te tillë është paksa jo ne rregull. Po ashtu te pika e gjashtë, kanalet e komunikimit nder të tjera thotë përgjegjësitë përgjithësisht komunikimet e komunës brenda administratës komunale, dhe kjo ishte arsyeja që pyeta a ka te bëj komunikim të komunës me qytetarët dhe grupet e interesit apo ka të bëj me komunikim të brendshëm të komunës pasi komunikimi i brendshëm është i rregulluar qartë dhe te kjo hyn pjesa e emaileve pastaj intraneti qeveritar që unë pe shoh si komunikim te brendshëm. Po ashtu te audienca thotë te punësuarit ne administratën komunale te Rahovecit, kështu që e shoh që me shume pika po trajton komunikimin e brendshëm te administratës se komunës dhe unë po besoj që duhet me qenë strategji te komunikimit te komunës me qytetarin për informimin e qytetarit.

Kryetari – Mendoj që zytari i informimit edhe pse nuk është prezentë, por, se bashku me Blertën dhe ekipin janë duke bërë një punë të mirë pasi nuk ka trend që nuk e përcjellin në Republikën e Kosovës sa i takon trajnimeve dhe përgatitjeve për me pas një strategji të qartë të komunikimit edhe me publikun por edhe të komunikimit të brendshëm brenda administratës, por, edhe ndërmjet administratës tonë dhe administratës shtetërore. Pra, unë mendoj se është një dokument i përgatitur me kujdes dhe i cili është i bazuar në trajnimet të cilat i ka bërë zytari për informim dhe bashkë me zyrtarë të tjerë që komunën tonë e qesin vërtet transparente që tre vjet radhazi dhe kush më mirë se ky ekip që i përcjellin këto. Ndoshta e keni te paqartë se a është strategji e konsultimit publik a për qytetarët apo për komunikim të brendshëm. Unë mendoj se për të gjitha, pasi janë disa indikator që kemi njerëz të përkushtuar dhe dinë ta bëjnë punën me se miri pasi që me siguri do të kishim ngelur me transparencë, pasi kanë bërë shumë trajnime me OSBE-në, me punëtori të ndryshme pastaj me kolegjiun të asociacionit dhe i ka dy komponentë si strategjinë e komunikimit me publikun por edhe strategjinë e informimit dhe komunikimit brenda administratës dhe në relacion ndërmjet administratës tonë dhe administratës shtetërore.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, atëherë e qesim në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht miratohet vendimi për miratimin e Draft strategjisë komunale për informim dhe komunikim. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e çmimit “ Ukshin Hoti”.

Kryetari – Kam kënaqësinë që kuvendit të komunës së Rahovecit ti propozoj miratimin e një vendimi për themelimin e çmimit Ukshin Hoti, i cili çmim i bën nder jo vetëm neve por gjithë kombit shqiptar. Rreth arsyetimit të vendimit dhe biografisë e veprimtarit të çështjes kombëtare Ukshin Hoti. U lind me 17 Qershor 1943, nga nëna Fatime dhe babai Nazifi, ishin njerëz të zakonshëm të cilët rriten edhe 5 fëmijë të tjerë pra 3 djem dhe 3 vajza. Kushtet dhe rrethanat që u rrit dhe u edukua Ukshin Hoti ishin të vështira mirëpo falë punës së babait të tij si gazetashitës ai pati mundësi të jetë mes librash e gazetash qysh në fëmijërinë e hershme. Ishte jo konvencional dhe gjithmonë në kërkim të rrugëve dhe alternativave të ndryshme. Ukshin Hoti e nisi rrugëtimin drejt dijes dhe shkencës nga fshati i tij Krushë e Madhe dhe nuk ndaloj se kërkuari të vërtetën të drejtën dhe barazi ngjat gjithë jetës. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Prizren dhe Prishtinë, shkencat politike i kreu në Zagreb, kurse dy vite studime pas universitare i kreu në Beograd në seksionin për marrëdhënie ndërkombëtare politike dhe ekonomike. Specializoj një vit edhe në universitet amerikan si në Çikago, Harvard, Boston dhe në Washington. Thellimi i njohurive shkencore mbi baza politike dhe empirike e bën Ukshin Hotin ekspert në marrëdhënie ndërkombëtare dhe një nga njohësit me të mirë të konflikteve etnike jo vetëm në rajonin e Evropës juglindore, por, edhe më gjerë. Bazuar në këto njohuri ai e arsyetoj qartë edhe me argumente shkencore nevojën e avancimit të statusit të Kosovës të statusit të shqiptarëve në ish Jugosllavinë komuniste, ku në një mbledhje të organizatës bazë të lidhjes komuniste të fakultetit filozofik në Prishtinë 19 nëntor 1981 magjistër Ukshin Hoti do të mbështesë kërkesën e studenteve dhe të popullit të Kosovës që Kosova të behet Republike njësi e barabartë administrative në republikën federative të Jugosllavisë, pra Kosova të behet republike. Kjo mbështetje e argumentuar shkencërisht i shkakttoj shumë vuajtje, e përjashtuan nga mësimdhënia si profesor i rregullt i fakultetit filozofik dhe e dënuan me 9 vite burg. Gjykata supreme ja uli dënimin në 3 vjet e gjysme, dënim që e vuajti në tërësi, pas kësaj u kthye në Krushë të Madhe dhe e bëri një jetë të zakonshme duke qënë i izoluar dhe i vëzhguar 24 ore rresht. Izolim nga pushteti i atëhershëm dhe ostracizmi si e quan Hoti ndikuan në gjendjen e tij shpirtërore dhe fizike, megjithatë bindjet e tij politike mbeten të palëkundura. Vazhdoj të argumentoj shkencërisht të drejtën e shqiptarëve për liri dhe pavarësi, gjë që ndikoj në raportet e tij personale me shoqërinë dhe pushtetarët lokal e qendror. Argumentet politike dhe shkencore i argumentoj në veprat e tij, si Lufta e Ftohtë dhe detante 1975 dhe në veprën politike Filozofia politike e çështjes shqiptare 1995. Ndërsa në vitin 2000 u botua përmbledhja e letër këmbimit me shkrimtarin Ismail Kadare

me titull „ Bisedë përmes hekurash,,. Në dorëshkrim ruhen edhe shume materiale te tjera publicistike ese letërkëmbimi e materiale te tjera me karakter shkencor. Edhe pas rënies se sistemit pushtues, Ukshin Hoti do te vazhdoj te qëndroj ne pozitë te larta te hierarkisë se mendimit politik shqiptar. Pjesëmarrja ne tubime popullore tryeza shkencore debate e polemika eseistike do te kenë ndikim te madhe ne formësimin e politikave shqiptare karshi dhune e represionit sllav. Këto qëndrime bëjnë që pushteti okupues serb ta mbaj ne vëzhgimin e pandërprerë ndërsa klasa e re politike ne ish jugosllavi ta konsideroj edhe jo aq te dëshirueshëm ekstremist e te jashtëkohëshëm. Ky izolim i vazhdueshëm dhe ngushtimi i hapësirave për veprimtari legale politike ndikuan që te kaloj për pak kohë ne Lublanë te Sllovenisë ku do te botoj pikëpamjet e tij politike ne revistat ne gjuhën shqipe alternative „ Alternativa,, e sidomos ne revistën e tij Demokracia autentike ne vitet 1990-1991. Pas kthimit ne Prishtinë për pak kohë punoj ne fakultetin filozofik me çrast edhe e punoj disertacionin e doktoratës duke mos pasur mundësi që ta mbroj publikisht. Ne vitin 1993 u arrestua dhe u dënua me dy muaj, për arsye se kishte organizuar homazhe ne nderim te katër dëshmorëve nga milicia serbe me 27 janar 1990 ne fshatin Brestoc, ku ne te njëjtin vit u rrah keq nga forcat speciale serbe ne Komoran pasi që i kishte vizituar pjesëmarrësit e grevës se urisë ne pallatin e shtypit ne Prishtinë e organizuar nga veprimtari i çështjes kombëtare Adem Demaçi. Milicia serbe e arrestoj edhe njëherë me 17 Maj 1995 ne afërsi te Rahovecit ,ku u akuzua për cenim te rendit kushtetues serb dhe për përgatitje te luftës se armatosur. Gjykata serbe ne Prizren e dënoj me 5 vite burg dhe pikërisht ne ditën kur i përfundoj ky dënim me 16 Maj 1999 u nxorr nga burgu serb ne Dubravë te Istogut dhe nga ia moment nuk dihet ende vendndodhja e tij. Familja dhe shoqëria vazhdon që ta kërkoj ndriçimin e fatit te tij. Edhe përkundër mungesës se tij fizike, shoqëria shqiptare ka bashkëjetuar me idetë politike çlirimtare kombëtare te Ukshin Hotit. Pikëpamjet e tij për zgjidhjen e çështjes shqiptare vazhdojnë te mbeten aktuale ndërsa argumentet e tij shkencore për domosdoshmërinë e bashkimit shqiptarëve sikundër hegjemonisë serbe qarkullojnë qarkullojnë ne çarçet politike akademike shkencore shqiptare. Fryma e tij atdhetare stoicizmi dhe lufta e pa kompromis me te vërtetën shkencore historike e bëjnë Ukshin Hotin një nder ideologët me më ndikim ne jetën politike shkencore e akademike. Vlerësimet për Ukshin Hotin nga figurat e shquara te kombit shqiptar janë shume domethënëse dhe ne po shkëpusim një thënie te akademik Rexhep Qosja i cili nder te tjera pohon, Ukshin Hoti ky sot është simbol i vetëdijes historike i ndërgjegjes dhe i qëndresës se pamposhtur shqiptare. Nuk është e çuditshme se ky është emri me i kuptimshëm me domethënëse me frymëzues ne jetën tone politike sot dhe kjo tregon se populli ynë e çmos ashtu siç duhet njeriun e gatshëm për sakrifica. Ndërsa shkrimtari me përmasa botërore Ismail Kadare do te shkruaj, kam frikë se pikërisht se ky nivel i lartë ka qenë edhe burim i fatkeqësisë që e ka ndjekur hap pas hapi këtë martir. Është e papranueshme që një personalitet i një populli pavarësisht se çfarë dije i përket ose nuk i përket te mbahet ne zingjir, është fyerje per krejt atë popull, me fort se kurrë populli shqiptar ka nevojë për njerëz te aftë e me nivel te lartë. Njerëzit e zotë janë princat e vërtet te një kombi e për fat te keq princat goditën shpesh ne mënyrë te vdekshme. Këto dhe argumente te tjera shkencore,e mbështesin fuqishëm idenë e themelimit te çmimit Ukshin Hoti, çmim që mund te ju ndahet personaliteteve politikes kulturës e të trashëgimisë historike dhe kombëtare si dhe personaliteteve me ndikim ne jetën publike e shoqërore. Pra ky çmim mund te ju jepet te gjithë atyre që kanë kontribuar personaliteteve individëve familjeve emblematiche që kanë kontribuar për lirinë për çlirimin e Kosovës për çlirimin e pjesës se robëruar te atdheut te atyre që kultivojnë dhe e ruajnë vlerat dhe traditën kombëtare historike por gjithashtu që i mbrojnë vlerat e këtij populli, por mund te ju jepet edhe personaliteteve te huaja që kanë kontribuar për çështjen tonë shqiptare fatkeqësisht akoma ende te pazgjidhur.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryetar Smajl Latifi, por, me përgjegjësinë me te madhe dhe përkundër emocioneve po ju them se ky propozim nga ana juaj dhe po besoj që do ta aprovojmë, do te ishte

vendimi me i mirë që ka marr ky kuvend prej që ekziston. Si krushjanë si bashkëpunëtor dhe si njëri që i kam qëndruar pranë deri ne momentet e fundit jam shume i lumtur që asambleja komunale ku jam edhe unë pjesë e saj do ta voton një çmim të tillë. Faleminderit juve kryetar dhe te gjithë kuvendaret e po ashtu ju ftoj që ta votoni këtë propozim nga kryetari i komunës z. Smajl Latifi.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatoj se ne mënyrë unanime miratohet propozim vendimi i kryetarit te Komunës për themelimin e çmimit „Ukshin Hoti,„. Kalojmë ne piken e tetë te rendit te ditës:

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P – 71510066 – 00386-1,ZK – Pastasel.

Afrim Oruqi - Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, anëtar te Kuvendit. Para jush keni propozim vendimin për shpalljen me interes te përgjithshëm te parcelës P- 00386-1 ne zonën kadastrale ne Pastasel. Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele është 2 hektar 20 ari e 5 m2 dhe ne po kërkojmë prej juve që te shpallim me interes te përgjithshëm ne sipërfaqe prej 10 ari. Pronar i kësaj sipërfaqe është ekonomia e pyjeve. Qëllimi i shpalljes se interesit te përgjithshëm është caktimi i lokacionit për ndërtimin e një objekti për aktivitete kulturore sportive dhe për nevojat e komunitetit. Drejtoria e gjeodezisë kadastrës dhe pronës do te kujdeset për rregullimin e dokumentacionit ne te ardhmen. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit, te votojnë propozim vendimin për shpalljen me interes te përgjithshëm.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar për këtë pikë, e qesim ne votim. Konstatoj se me shumicë te votave miratohet propozim vendimi për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P – 71510066-00381-1,ZK-Pastasel.Kalojmë ne pikën e nëntë te rendit te ditës:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P – 71510057 – 02172-1,ZK-Rahovec.

Afrim Oruqi – Para jush keni vendimin vendimin për shpalljen për interes publik për parcelën P – 71510057-02172-1, në zonën kadastrale në Rahovec. Behet fjalë saktësisht për parcelën mbi shkollën Bekim Sylka që është zonën kadastrale në qytet, pra fjalë është për 22 ari 61 m2. Për momentin kjo pronë është ne emër te organizatës punuese „Sharri Pylltaria“. Qëllimi shpalljes se interesit te përgjithshëm është ndërtimi i një mjedisi parku rekreativë inovativ i cili do te shërbej për rekreacion dhe inovacion për qytetaret e komunës se Rahovecit. Drejtoria e kadastrës gjeodezisë dhe pronës do te kujdeset për rregullimin e materialit ne te ardhmen. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit që ta votojnë propozimin vendimin për shpalljen me interes te përgjithshëm te parcelës P-71510057-02172-1,ZK-Rahovec.

Kryesuesi – Meqë nuk kemi te lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht miratohet pika e nëntë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dhjetë te rendit te ditës:

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e vendit (lokacionit)për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit te fshatit Çifllak.

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtar te kuvendit, para jush keni vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve te ndryshme për nevojat e komunitetit te fshatit Çifllak. Bëhet fjalë për pronë me numër Nr.00169-1 me sipërfaqe te përgjithshme 35 ari 41m2. Kjo pronë është e evidentuar ne posedim te pronë shtetërore KK. Rahovec mirëpo ne po kërkojmë prej juve që te caktojmë lokacion pjese te parcelës me sipërfaqe prej 3 ari, për ndërtimin e objektit kulturor edukativo sportiv me sipërfaqe prej 3 ari. Prona e paluajtshme dhe objekti që do te ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik pra pronar i saj mbetet kuvendi komunal Rahovec dhe si e tillë nuk mund te tjetërsohet. Drejtoria për gjeodezi kadastrë dhe pronë do te kujdeset ne të ardhmen për rregullimin e dokumentacionit. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit te votojnë propozim vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit kulturor edukativ sportiv.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatohet se unanimisht miratohet edhe propozimi vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e fshatit Çifllak. Kalojmë ne pikën e njëmbëdhjetë te rendit të ditës:

11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendimit për caktimin e vendit (lokacionit) për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe me gjerë.

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtar të kuvendit, ne sot ju kemi prezantuar edhe një skicë të terrenit nga zona në fjalë Hoçë e Vogel, ku saktësisht është e precizuar kufijtë e pronës publike dhe ku po ideohet që të caktohet lokacioni për ndërtimin e morgut në fshatin Hoçë e Vogel. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogel dhe me gjerë. Pra behet fjalë për parcelën me Nr.00813-0 me sipërfaqe të përgjithshme të kësaj parcele 3 hektar 55 ari e 95m². Ne po kërkojmë prej juve që të marrim vendim dhe të caktojmë lokacion me sipërfaqe prej 5 ari. Ky objekt do të financohet nga donator kryesisht të fshatit Hoçë e Vogël, ku aktualisht atje në vend gjithmonë kanë ekzistuar varreza edhe pse në certifikatë të pronës shkruan se titullar i pronës është komuna e Rahovecit mirëpo në terren janë varrezat e civileve dhe të dëshmorëve të fshatit Hoçë e Vogel. Drejtoria për gjeodezi kadastrë dhe pronë në të ardhmen do të kujdeset që të rregulloj dokumentacionin e nevojshëm. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit të votojnë propozimin për caktimin e lokacionit e morgut për fshatin Hoçë e Vogël dhe me gjerë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për prezantimin, mirëpo kisha kërkuar nga drejtori edhe për një prezantim pasi ka qenë një ankesë prej banoreve të fshatit Hoçë e Vogel të na sqarojë këtë pjesë.

Afrim Oruqi – Në zyrën e kryetarit të komunës të kuvendit komunal të Rahovecit ka ardhë ashtu siç ka ardhë edhe në vitin 2021 kërkesa e banoreve të fshatit Hoçë e Vogël për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut e me pastaj ka ardhë edhe një ankesë e disa banoreve të komunitetit që e kanë kundërshtuar. Në jemi takuar me të dy palët pasi ky është edhe obligimi i jonë dhe kemi pranuar një ankesë me mbi 70 nënshkrime të fshatit Hoçë e Vogel dhe gjithashtu një kërkesë tjetër të qytetareve të fshatit Hoçë e Vogël që kanë mbi 250 nënshkrime. Qëllimi i jonë është që të vendosim në drejtim të shumicës që besoj që është edhe i gjithsecilit prej juve. Ne jemi sqaruar me të dy palët edhe me ata që janë ankuar edhe me ata që kanë kërkuar, pasi që është pronë e kuvendit atëherë edhe i takon kuvendit komunal me caktim lokacion për ndërtimin e këtij morgu. Kryesia e fshatit kanë mbledhur donacion për me ndërtim këtë morg për nevojat e komunitetit. Kështu që jemi në rregull edhe me palën ankuese edhe me palën që kanë kërkuar për me caktim një lokacion për me ndërtim morgun. Kemi pasur sqarime edhe me urbanizmin pastaj me kadastrë kemi shkuar se ku janë rrugët dhe gjithçka jemi në rregull sipas ligjit dhe procedurave në fuqi.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatohet se unanimisht miratohet pika e njëmbëdhjetë te rendit të ditës. Kalojmë ne pikën e dymbëdhjetë te rendit të ditës:

12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private – për interesin publik.

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtar të kuvendit, para jush kemi vendimin për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private – për interesin publik. Ka të bëjë me miratimin, miratohet propozimi i kryetarit të komunës i datës dhe jepet pëlqimi për këmbimin të pronës publike komunale me pronë private për interes publik e cila gjendet në vendin e quajtur Padina, zonë kadastrale në Rahovec, me nr.01473-0. Sipas certifikatës së pronësisë kjo është pronë e komunës së Rahovecit dhe sipërfaqe që do të merret kësaj parcele është 69m² dhe gjithashtu e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 11 ari 23m². I jepet në posedim Mehdi Baki Shehu nga Rahoveci ndërsa ngastra sipas certifikatës së pronësisë 0147-3 në posedim Mehdi Baki Shehu nga Rahoveci me sipërfaqe të përgjithshme prej 13 ari 60 m² i merret pjesa e parcelës me sipërfaqe të njëjte prej 69m² dhe i jepet komunës së Rahovecit në emër të këmbimit të zgjerimit të rrugës publike në Rahovec. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme me pronë

private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është për interes publik përkatësisht për zgjerimin e rrugës publike ne Rahovec dhe se ne te njëti vend nuk ekziston parcela tjera komunale te përshtatshme. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit te votojnë propozim vendimin për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private.

Ilir Pallqa – I nderuar kryesues, kryetar, drejtor te drejtorive, kolegë asamblistë. Seancën e kaluar për këtë çështje jam gjykuar si paragjykues kurse tash po e shohim se atë çka e kam thënë ne formë te pyetjes po del e saktë dhe gjithashtu atë që e kam thënë ne seancën e kaluar nuk është se kam zbuluar diçka te madhe, pasi ju jeni te parashikueshëm dhe ne nuk befasohe mi prej juve pasi nëse nesër hapet një konkurs pune ne Rahovec te gjithë e dimë se kush do te punësohet dhe kjo është arsyeja se ne nuk befasohe mi nga ju se ju jeni te parashikueshëm. Mendoj se do te përmendeni për këto matematika dhe pazare. Po kthehemi të çështja e këmbimit , ne seancën e kaluar ju kam bërë me dije se aty është një objekt i ndërtuar dhe ju thatë se ne nuk dimë pasi që ne regjistrin kadastral nuk figuron. Me datën 15 mars komisioni ka qenë ne atë pronë për me bo vlerësimin dhe nëse vërtet kanë qenë atëherë me siguri e kanë parë objektin aty dhe kanë heshtë dhe sipas tyre çdo gjë është ne rregull dhe mund te behet këmbimi. Në te dhënat e pronës që i kemi ne material po figuron që është pronë bujqësore dhe ka aktualisht arë aty dhe vreshta nga prapa. Pra për derisa ka qenë komisioni aty atëherë ju jeni ne dijeni se ka kontest, pasi e kanë parë si qëndron gjendja reale aty. Prape po heshtni dhe po mundoheni që me shty përpara këtë çështje, ju duhet te tregoni drejt se si qëndron gjendja reale, unë do te jem pro mirëpo jo me manipulue. Gjithashtu një falënderim për drejtorin pasi seancën e kaluar kam kërkuar kërkesën e banoreve te lagjes dhe ne fillim te seancës ka ardhë.

Afrim Oruqi – Në pyetjen e kuvendarit Ilir Pallqa, se ne kemi mbajtur te fshehur se aty ekziston një objekt. Objekti është nga viti 2007 dhe objekti është me lejen dhe ekziston projekti kryesor për objektin, me leje ndërtimi 12 pika 17 prej datës 11.12.2007 është lejuar ndërtimi i objektit me kushte te ndërtuara me vendim mbi banim, me drejtori arkitekt Teuta Jaha – Hoxha. Përveç që ka ndërtuar objekt gjithashtu ka marr leje dhe ju ka nënshtruar pagesave te parapara me ligjet edhe rregulloret te komunës se Rahovecit, ne vlerë 1415,30 cent. Ata që po dyshojnë që objekti nuk ka leje ndërtimi dhe te gjithë e kemi dit se ka objekt aty dhe ne e kemi shqyrtuar kërkesën e banoreve që e kane siguru kryetarët e grupeve parlamentare këtu, që ka pasur dilemë se a kanë kërkuar pasi që ne kemi qenë ne vend aty me komision për vlerësim te pronës dhe kemi parë që rruga të Përboqtë është diku 2.70cm. Më vjen keq që për shkaqe teknike nuk mundemi me prezantu ne projektor, por ata që janë ekspert te fushës ne gjeoportali munden me pa se gjysma e vendbanimeve te komunës se Rahovecit do te dalin me vija te zeza mbi kulmet e tona. Këtu e kam një raport që përveç lejes që e ka hartua ne vitin 2017 Demos-i dhe aty janë te gjitha pronat publike që janë ne uzurpim dhe prape ne këtë raport janë mbi 220 parcela nuk figuron kjo parcelë që ka uzurpue pronë publike. Kështu që edhe raportin edhe lejen kushdo që është i interesuar munden me i pa pasi që janë transparente dhe publike dhe munden me i pa qytetarët e komunës se Rahovecit.

Ilir Pallqa – Në materialin që e kemi, lloji i shfrytëzimit të parcelës po figuron që 1170 m është bujqësore vreshta dhe 190 m, kështu që nuk po figuron objekt dhe pastaj ju thatë që nuk figuron në pronat e uzurpuara. Mendoj se përgjegjësia ju takon juve dhe duhet të dërgoni inspektoratin dhe njeri prej komisionit vlerësues që ka qenë aty është gjeodet dhe te paktën ai është deshtë që të informojë ty nëse ka parë që është në pronë publike ai ndërtim ose një pjesë e atij ndërtimi rreth 69 m2 sipas jush, kështu që unë skam aspak faj në përgjegjëshmërinë tuaj.

Afrim Oruqi – Përgjegjësia e imja është ndërtuar ne vitin 2007 sipas ligjeve te Kosovës dhe nëse i ka kaluar 10 vjet mbi bazën e ndërtimit ose shfrytëzimit atëherë ky pronar i takon e drejta e shfrytëzimit te asaj prone pa pengim që fatkeqësisht ka shume si kjo dhe nuk po e kontestoj se a prek vija kufitare apo jo. Qëllimi i jonë është me ju gjete qytetareve ne atë komunitet, me zgjeru atë rrugë dhe me rregullu një

ndërtim ose një pjesë e atij ndërtimi, rreth 69 m2 sipas jush, kështu që unë skam aspak faj ne papërgjegjshmërinë tuaj.

Afrim Oruqi – Përgjegjësia e imja është ndërtuar ne vitin 2007 sipas ligjeve të Kosovës dhe nëse i ka kaluar 10 vjet mbi bazën e ndërtimit ose shfrytëzimit atëherë ky pronar i takon e drejta e shfrytëzimit të asaj prone pa pengim që fatkeqësisht ka shume si kjo dhe nuk po e kontestoj se a prek vija kufitare apo jo. Qëllimi i jonë është me ju gjete qytetareve ne atë komunitet, me zgjerue atë rrugë dhe me rregullue një problematike. Kështu që nuk është as e para dhe as e fundit, keni me pas edhe ne seanca tjera edhe ne pika tjera pasi shume nga këta asamblast të legjislaturës se kaluar kemi pasur ne çdo seancë ku kemi rregulluar problematika të se njëjtës fushe. Kështu që unë ju ftoj me votue këtë propozim për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private.

Bejtullah Deliu – Unë deshta pak të ndërlidhem me pikë të rendit të ditës dhe me përgëzue drejtorin këtu vetëm ne këtë pikë por gjithashtu me kërkua nga drejtori që edhe ne pika tjera të furnizohemi me materiale kështu të llojit të këtillë sepse kemi kërkuar edhe ne KPF që të kemi materiale sa me tepër e sidomos ne seanca të këtilla të jemi sa me të qartë. Gjithashtu edhe Iliri që e ngriti shqetësimin faktikisht qëndron deri diku pasi ne material nuk kanë qenë të specifikuara sipas lejes që e prezantoj mirëpo me këto nënshkrime që janë kërkuar nga qytetaret dhe gatishmërinë e personit që e ka marr ne këmbim të kësaj prone për me i lirue qytetaret që me hecë lirshëm, po besoj që edhe rastet e tjera duhet të kenë vullnet të këtillë dhe ti gjendemi komunitetit tonë që të kenë çasje sa me të mirë ne pronat e tyre apo ne rrugën ku kalojnë. Mendoj që këtu nuk është dashtë të vazhdoj me tepër ky debat por të inkurajojmë edhe rastet e tjera ku mundemi të i gjendemi ne si asamblastë dhe ti zgjidhim problematikat e këtilla.

Burim Krasniqi – Unë e kam vetëm një pyetje, vetëm dua të di proceduralisht a jemi ne rregull në këtë proces, pasi jam inxhinier dhe nuk jam jurist dhe nuk dua të votoj diçka të dëmshme.

Afrim Oruqi – Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi, unë me përgjegjësi të plot i them se sot i kam gjashtë pika dhe që të gjitha këto pika janë proceduralisht janë ne rregull dhe po ashtu krejt këto pika kalojnë ne MAPL dhe atje janë zyrtaret ligjor që e filtërojnë dhe çka do që nuk është ne rregull bien ne kundërshtim me ligjin dhe na njoftojnë neve, pasi që janë njerëz profesionist të fushës ne MAPL dhe bën monitorimin e të gjitha vendimeve që i dërgojmë, kështu që gjithçka është ne rregull.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet, atëherë e qesim ne votim. Konstatoj se me 22 vota pro, miratohet propozim vendimi për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private për interes publik. Kalojmë në pikën e trembëdhjete të rendit të ditës:

13. Informatë për listat e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre.

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtar të kuvendit, para jush keni informatën për listat e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre. Ne e parashohim për çdo vit, pasi vitin e kaluar e kemi paraparë për sivjet, ku njëherë ne vit i informojmë kuvendarët lidhur me objektet ,pronat që i menaxhon komuna e Rahovecit, kështu që të gjitha i keni të listuara ne material që keni para vetes, ku janë 34 zona dhe ne çdo zonë ku edhe qyteti është një zonë dhe ne çdo zonë kadastrale të komunës së Rahovecit kuvendi ka prona komunale ka objekte dhe menaxhohet sipërfaqja e përgjithshme e tyre dhe totale e kemi të paraparë ne çdo parcelë zonë për zonë.

Burim Krasniqi - Kur vinë informatat ne assembleje, a ekziston mundësia me pas një tabelarë të formatit zyrtar që i drejtohet nga drejtori për assemble komunale me qenë pak me formale apo zyrtare.

Kryetari – Po sigurisht se keni me pas një format tjetër të vendosjes së materiale, pra do të keni laptopat dhe nuk do të keni gjithë këtë material që ta keni pranë vetes dhe do ta keni me lehtë dhe mundësi me të mirë për me dhanë kontributin e juaj si asamblast.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar për sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e katërbëdhjetë të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft vendimit për shpalljen e pronave me interes të përgjithshëm.

Kryesuesi – Te nderuar anëtar te kuvendit komunal, i nderuar kryetar i komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar Fatmir Iska, drejtor te drejtorive, media, përfaqësues te organizatave , i nderuari z. Ylber Shamolli përfaqësues i kompanisë përkatëse për çështjen ne fjalë. Ne zyrën kryesuesit te kuvendit komunal dhe po ashtu edhe ne zyrën e kryetarit te komunës ka ardhur një kërkesë për një investim në zonën e Zatriqit për energji te ripërtërish me me saktësisht vendosja e turbinave te erës për prodhim te energjisë elektrike . Kompania ne fjalë EV- wild park shpk ka marr pëlqimet dhe aprovimet përkatëse nga ZRREA dhe i ka bërë te gjitha studimet teknike mjedisore dhe financiare te nevojshme për zhvillimin e parkut energjetik Zatriq 1 dhe Zatriq 2 me kapacitet total instalues prej 70mw, i cili projekt planifikohet te ndërtohet sa me parë duke pasur parasysh edhe strategjinë për zhvillimin e energjisë se pastër me fokus te veçantë ne zhvillimin e sektorit energjetik duke mundësuar kalimin drejt një karbonizimi te sistemit energjetik te Republikës se Kosovës. Kemi edhe strategjinë e Republikës se Kosovës prej vitit 2018 – 2026 ku ka paraparë edhe ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme te energjisë. Si komunë e Rahovecit por edhe si kryesues i kuvendit komunal por edhe si asamble komunale ne tërësi po besoj që jemi te nderuar me një investim te tillë që di te behet ne komunën e Rahovecit, investimet e tilla që janë edhe me interes nacional drejt një zhvillimi energjetik si dhe drejt pavarësisht nga importi i energjisë elektrike. E kemi fatin që pjesa e Zatriqit i parasheh kushtet e nevojshme për një investim të tillë duke i paraparë kushtet klimatike. Kompania ne fjalë i ka përfunduar te gjitha lejet licencat lejet mjedisore përkatëse që u deshtë me u përfundue për implementimin e një projekti te tillë. Kështu që kuvendi komunal duhet me marr vendim që kjo kompani është instanca e fundit tash kuvendi komunal që ky projekt te kaloj drejt implementimit për shpalljen me interes te përgjithshëm parcelat ku do te vendosen turbinat e erës. Për çfarëdo pyetje që mund te keni, e kemi edhe zyrën ligjore që e ka hartuar planin dhe materiali që keni para jush, diskutimi është i hapur për çfarëdo pyetje që mund ta keni sa i përket kësaj pike.

Kryetari – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, anëtarët e kuvendit, përfaqësuesin e operatorit. Unë prita që kryesuesi me thanë që komunës se Rahovecit munden me i ardhë 90 milion që është energji e ripërtëritshme apo alternative dhe ne këtë krizë ku bën pjesë edhe Kosova ne kuadër krizës botërore energjetike, nevoja për energji te ripërtëritshme pra energjia alternative është shume e madhe. Pra është shumë mirë që komuna e jonë e ka këtë mundësi dhe ne jemi dakordue me kryesuesin që kryesuesi ta paraqes dhe unë i qëndroj prapa edhe kryesuesit edhe kuvendit edhe kërkoj votën kuvendit për ta miratuar këtë plan investiv që besoj që i bën nder por edhe i jep mundësi komunës tonë por njëkohësisht edhe Republikës se Kosovës. Meqenëse te gjitha procedurat kanë kaluar dhe ne kemi mjedis te përshtatshëm për zbatimin e këtij projekti investiv atëherë po besoj që serioziteti i investitorit bashke me monitorimin e komunës por edhe te instancave tjera te shtetit tonë do ti japin mundësi komunës tonë që te kthehet në një epiqendër te prodhimit te energjisë nga turbinat e erës. Pra unë jam pro këtij investimi dhe po besoj që prezantimi i kryesuesit ne arsyetimin e kësaj pike bashke me zyrën ligjore janë ne akordancë edhe me komunën dhe po besoj që do te harmonizohen duke e miratuar këtë kërkesë apo propozim vendim për shpalljen me interes te përgjithshëm te atyre parcelave që i keni ne dokumentacion ne zonën kadastrale ne Zatriq. Pra pritet me ndodh investimi me serioz që ka mundur me i ndodh komunës se Rahovecit prej luftës se dytë botërore. Po ashtu po besoj që investitori e ka te qartë se sa është i nevojshëm dhe i mirë ky lloj investimi por edhe sa është i nevojshëm jo vetëm për komunën tonë për atë që quhet ngritje e kapaciteteve apo zgjerim te kapaciteteve me energji me energji te ripërtëritshme apo alternative që edhe ne shkallë shtetërore është projekt shume i rëndësishëm. Unë i ftojë anëtarët e kuvendit te komunës që ta miratojnë këtë propozim vendim që u prezantue me se miri prej kryesuesit te kuvendit te komunës. Kështu që kemi prezent edhe përfaqësuesin e autorizuar te operatorit i cili mund te jep shpjegime nëse ne ja japim lejen komuna se bashku me kuvendin.

Lirigzon Kastrati – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, kolegë asamblastë. Në emër te grupit te asamblastë te LDK-së e përkrahim propozim vendimin për shpallje te interesit te përgjithshëm dhe çdo investim që vjen ne komunën e Rahovecit.

Leonard Morina – Përhëndetje kryesues, kryetar, drejtor, kolege asamblastë dhe gjithë te pranishmit. Duke i pasur parasysh pasurit natyrore te komunës se Rahovecit, ne nuk kemi bërë sa duhet për te sjellë investitorët ne komunën tonë. Tani jemi me fat që ne komunën tonë kompania ne fjalë ka shpreh interesim për te investuar afër 90 milion euro. Ne si grup nga radhët VV-së do ta mbështesim këtë propozim, e po ashtu kërkoj nga kryetari i komunës që te kërkoj te ju gjej edhe investime tjera për me sjell ne komunën tonë, pra duhet te bëjmë me tepër që ne të i gjejmë kompanitë.

Bejtullah Deliu – Përhëndetje për te gjithë. Investimet e këtilla sigurisht se janë te mirë se ardhura ne komunën tonë e gjithashtu uroj që te gjitha procedurat te kalojnë si është më se miri dhe investimet e tilla te kemi sa me shume dhe jemi pro investimeve te tilla.

Rumir Zhuniqi - I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, kolege asamblastë dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Edhe ne si grup i AAK-së jemi pro investimit te tillë dhe e mbështesim këtë pikë te rendit te ditës, pasi jemi ne rrjedha te këtij projekti dhe gjithashtu personalisht sa kam qenë drejtor i Urbanizmit që ky projekt ka vazhdue me pajisjen e pëlqimeve ne ministri me te cilin jemi informuar edhe si drejtori, kështu që jemi pro dhe mirëpresim gjithmonë kesi lloj investimeve te tilla.

Kryetari – Mendoj se kryesuesi shumëçka tha por jo te gjitha, mirëpo kjo nuk do te thotë që unë i di, pasi vlerën e kam ditë unë pasi këto letra kanë ardh shume me herët pasi ne me herët nuk kemi pasur te drejtë me dhanë ne shfrytëzim por pas zgjedhjeve e kemi fituar te drejtën. Pra investitori sigurisht mirëpo edhe komuna e Rahovecit i ka krijuar lehtësira deri me tani siç po i krijon kuvendi i komunës tani. Pra ne jemi te gatshëm dhe i hapim dyert për investitorët madje edhe për dy edhe me shume edhe ne shume vende tjera te përshtatshme për turbina dhe ai që i bën këto investime besoj që i ndihmojnë edhe bizneset përreth dhe mendoj që edhe operatori ka me i shfrytëzua edhe mundësit edhe kapacitetet vendore kur fillojnë investimet.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatoj se me shumicë te votave miratohet edhe pika e katërbëdhjetë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e pesëmbëdhjete te rendit te ditës:

15. Informatë mbi zbatimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore te rrugëve në Komunën e Rahovecit.

Përparim Krasniqi - Përhëndetje për te gjithë. I adresohem kuvendit te komunës për informatën për implementimin e mirëmbajtjes se rrugëve gjate sezonës dimërore dhe verore. Në bazë te planit që ka kalue ne kuvendin e komunës ne vitin 2021, ku ne bazë te rregullit raportohet ne muajin mars për implementimin e projektit. Kështu që shkurtimisht i keni te gjitha shënimet ne materialin që keni para vetes , nëse keni ndonjë vërejtje sugjerim apo kërkesë nga ana e juaj e mirëpresim dhe do te jemi këtu që të ju japim informata shitesë. Në komitetin për Politike dhe Financa Burim Krasniqi ka kërkuar një sqarim rreth shpenzimeve mujore që ndodhin. Unë them se dimërori zakonisht ne bazë te komisionit që i verifikon punimet ne terrene dhe te menaxhmentit te projektit 18,000-20,000 euro janë shpenzimet mujore që përfshin periudhën 4 mujore dhe menjëherë pas kësaj periudhe fillon implementimi i sezonës verore.

Burim Krasniqi – Informata është mbi implementimin e projektit për mirëmbajtjen e rrugëve për sezonën dimërore. Në KPF pata kërkuar, që mendoj se përgjigja nuk duhet te jetë vetëm për mua por për t gjithë asamblastët, kështu që sa ka arrit komuna me shpenzue kontratën duke pasur parasysh se kontrata është për çmimin njësi, pra jo mujore por totali i kontratës p.sh. te loti 1 është 173,464, te loti 2 është 214,000 dhe loti 3 është mbi 73,000 euro. Kështu që sa është vlera e këtyre lotëve që janë shpenzua apo si përqindje totali,

pasi ato mjete që kanë mbete a do te barten tek mirëmbajtja verore apo kontrata e lejon që me u bart ne mirëmbajtjen dimërore te vitit te ardhshëm duke pasur parasysh se sezoni dimëror ka qenë me i butë se sa vitet e kaluara.

Përparim Krasniqi – Kontrata është 24 muajshe apo dy vjeçare plus 30 ditë sipas rregullave te prokurimit publik, është ne metër gjatësi pra secila loto e ka te specifikuar ne kontratë p.sh. nëse loti parë i ka shpenzuar 12,000 euro loti i dytë i ka shpenzuar 4800 euro dhe loti i tretë i ka shpenzuar 4000 euro por ne muajin e parë dhe tani fillon muaji i dytë,i tret e kështu me radhë. Pra sipas kontratës e kemi ne metër gjatësi dhe ne kuadër te metër gjatësisë ne pastrimin e rrugëve e sidomos gjate sezonës dimërore përfshihet edhe sasia e kripës ne magjistrale që vendoset aty d.m.th. ne paushall që ne metër gjatësi e ka sasinë e hedhur te kripës. Mirëpo e ka për detyre me vërejtje e ka për detyrë me pastrua rrugën dhe me i vendos kryp dhe nëse është trotuari duhet me vendos por nëse nuk ka borë gjate sezonës dimërore atëherë është i obliguar operatori ekonomik me bo pastrimin e mbeturinave përgjatë rrugëve.

Burim Krasniqi – Unë vetëm po pyes që kjo kontratë që është paraparë 173,000 euro për dy vite, vetëm po dua me dit se sa për qind e kontratës është shpenzuar, e kuptoj se matet me kilometër që i kalon kamioni ne bazë te tehografit , matet sasia kripës që hudhet, pastaj pastrimi kur ka apo nuk ka borë, por vetëm po pyes se sa është vlera e kontratës që është shpenzuar.

Përparim Krasniqi – Sipas kontratës ne e kemi kontratës 2022/2023 kështu që kontrata është dy vjeçare dhe ne muajin e parë e tash jemi ne muajin e dytë që kemi filluar e që ne mars përfundon, janë shpenzuar 10-15% e kontratës dhe kjo vazhdon edhe ne muajt tjerë ,kështu që nuk ka me tepër mundësi sepse jemi ne fillim te kontratës. Arsyeja se pse e kemi bo dy vjeçare sepse këto kontrata zakonisht kanë qenë një vjeçare ,pasi zakonisht ne fund te vitit po ndodh që shume komuna po mbesin pa kontrata për mirëmbajtjen dimërore dhe akuzohen komunat se pse nuk mirëmbahen rrugët edhe për këtë arsye jemi detyruar me kërkua prej KRKK-së që kontrata te lidhet dy vjeçare.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e gjashtëmbëdhjetë te rendit te ditës:

16. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e komisionit ad – hoc për shqyrtimin e kërkesave te kandidateve që kanë konkurruar për Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe.

Isak Hoti – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, delegatë te nderuar dhe gjithë ju te pranishëm. Vendimin që e kemi marr ne seancën e kaluar për themelimin e këshillit te fshatit Hoçë e Madhe është shfuqizuar vendimi i ministrisë se planifikimit hapësinor 11/2014 dhe si rezultat i kësaj na kanë kthyer te paligjshëm. Megjithatë sot ne do te vazhdojmë me ligj dhe do te bëjmë plotësim ndryshim e vendimit për shkak se ligji është ne fuqi edhe ne mundemi me fillue edhe me komisionin por edhe me plotësim ndryshimin e ligjit pa udhëzimin administrativ.

Burim Krasniqi – Në seancën kur është nxjerr ky vendim, kam kërkuar që komisioni për zgjedhjen e anëtarëve te këshillit te fshatit Hoçë e Madhe mos me qenë anëtar te fshatit për anëtarët që zgjidhen për përfaqësues te kuvendit. Pra komisioni ad hoc te përbehet veç prej delegateve te kuvendit, por prap po qëndroj prapa meqenëse udhëzimi administrativ është i shfuqizuar dhe i cili specifikon që 2 anëtar i ka kuvendi dhe 3 nga fshati, atëherë unë po kërkoj që kur te bëhet ky plotësim vendim atëherë ligji nuk e ndalon këtë që ne me caktue 5 anëtar te komisionit ku secili grup i asamblistëve me caktue nga një anëtar dhe një me caktue ekzekutivi edhe me shkua tutje, pasi ligji nuk e ndalon dhe nuk ka nevojë me pas anëtar nga këshilli i fshatit për me zgjedh përfaqësues te asamblesë sepse ata i kanë përfaqësues direkt edhe fshati edhe asamblist edhe kisha ne kishën e Hoçës. Kështu që unë po e kërkoj mirëkuptimin e asamblistëve që me qitë ne votim që komisioni ad hoc te përbehet nga 4 anëtar te secilit grup te asamblistëve nga një anëtar dhe një anëtar nga këshilli, për me pas mundësi me zgjedh anëtarët e këshillit prej dy anëtareve.

Isak Hoti – Problemi është se jemi te vëzhguar vazhdimisht nga anëtarët e OSBE-së që me siguri e keni pae dhe vet ne seancën që u morë vendimi edhe jam i sigurt që ky kuvend edhe ka votue kundër krejt ligjit por nuk guxojmë me dal jashtë kësaj pasi jam shumë i sigurt se dikush ka me ndërhyje prape edhe ka me plotësue edhe me ndryshue, sepse ne mundemi me lan edhe pa vendimin për ligjin e Hoçës së Madhe mirëpo nuk guxojmë me dal jashtë kësaj. Pasi ligji e thotë që janë aktet nënligjore te cilat e përcaktojnë me thellësisht e bile ky udhëzim administrativ është shfuqizuar si rezultat i ndërhyrjes së OSBE-së, për shkak të këtij vakumi institucional që ata e fillojnë mandatin me kuvendin edhe e përfundojnë me kuvendin, kështu që edhe pse u konsolidua kuvendi në ende edhe pas 3 muajve nuk kemi mundur me themelua këshillin për fshatin e Hoçë e Madhe, e rezultat i kësaj ata kanë kërkuar ndryshimin e ligjit. Kështu që vitin e kaluar në muajin dhjetor është shfuqizua ky udhëzim administrativ dhe ne kemi pasur presion edhe nga lartë në zyrën e kuvendit nga OSBE-ja dhe qarqe të tjera me të cilin kanë kërkuar që mos me pas vakum institucional, ku nëni 4 i ligjit kur flet për këshillin i përcakton 5 anëtar dhe konform kësaj e ka përcaktue edhe komisionin prej 5 anëtareve, kështu që ligji bëhet prej Hoçës atëherë dy i ka lanë nga kuvendi, dy nga këshilli i fshatit dhe një nga kisha ortodokse.

Burim Krasniqi – Kur ka qenë udhëzimi në fuqi, ka qenë e specifikuar qartë përbërja e komisionit ad-hoc dhe tash udhëzimi nuk është në fuqi. Kështu që ligji për Hoçën e Madhe nuk e specifikon dhe për faktin se nuk e specifikon atëherë ne nuk po bëjmë shkelje ligjore nëse bëjmë 5 anëtar të komisionit ad-hoc të kuvendit sepse ata e kanë përfaqësimin dhe me shume përgjegjësi e them se nuk jemi duke bërë shkelje ligjore pasi nga përvoja ime në administratë jam shumë i bindur se nuk jemi duke bërë shkelje ligjore.

Isak Hoti – Sikur të ishte folur vetëm për Rahovecin po besoj që do ishim marr vesh shumë lehtë por është duke u folur për një ligje specifik i cili ka pasur vazhdimisht telashe e polemika që kryetari i komunës e din me së miri që ka shkue deri në parlament të Kosovës. Kështu që nuk funksionon ndryshe pasi për mos me pas telashe me OSBE-në edhe do investime që i kemi pasur edhe disa ndihma që na japin vazhdimisht, mendoj që do dalim keq, pra pa anëtarët e fshatit Hoçë e Madhe ky komision ad hoc nuk bëhet.

Kryetari – Mendoj se nuk do të ishte mirë me u bo temë diskutimi kjo, pasi ata pasi kanë fillue me shfuqizue udhëzimin administrativ atëherë do të ishte mirë me shfuqizua edhe ligjin por sido qoftë është përgjegjësi e tjetër kujt. Qëndrimi i jonë rreth këtij ligji dihet por mos harroni se nga Hoçë e Madhe me janë ardh mbi dhjetë persona që kërkojnë me u bo anëtar të këshillit të fshatit. Në duhet me ndjek një parim pasi logjika e thotë se kuvendi i komunës duhet me ja lanë mundësin që për ata 3 me marr pjesë në komision ad hoc edhe nga Hoça e Madhe për shkak të konkurrencës dhe mos të del sikur kuvendi i komunës anëtarët e komisionit ad hoc të gjithë nga kuvendi po i preferojnë dikënd. Edhe unë do të doja që të 5 anëtarët e komisionit me qenë nga kuvendi ashtu siç e thae edhe ti Burim, por nuk po besoj që nuk prish punë kurrgjë edhe kështu pasi dy anëtar të kuvendit bashk me ekzekutivin e komunës kanë mundësi me ndihmue këtë procesin në cilësinë e komisionit ad hoc në procesin e përzgjedhjes të atyre që tre jo me automatizëm veçse i kanë vendet e rezervuara por se kush do të zgjidhet ky komision do të vlerësoj aplikacionet e secilit. Kështu që nuk duhet që ta aktualizojmë shume këtë temë dhe do të ishte mirë që të ju mbetet komisionit ad hoc ashtu siç janë, dy anëtar të kuvendit që i kemi bashk me ekzekutivin dhe gradualisht ky komision e bën përzgjedhjen. Pra nuk duhet ta aktualizojmë si temë çështjen këshillit të fshatit Hoçë e Madhe pasi ka mbikëqyrje edhe nga organizata tjera dhe të mos krijojmë përshtypjen sikur të gjithë anëtarët e komisionit ad hoc janë të gjithë nga kuvendi i komunës që bëjnë përzgjedhjen e anëtareve të këshillit. Pra jam për me votue ashtu siç e tha zyrtari ligjor pavarësisht a ka ndonjë praktik ligjore të kësaj natyre se a e parasheh krejt ligji apo nuk e parasheh. Pra ideja është me pas me shume pragmatizëm politik kuvendi i komunës që mos me na ardh edhe njëherë në seancën e prillit edhe njëherë kjo pikë.

Burim Krasniqi - Neni 4 i ligjit thotë që këshilli përbehet prej 5 anëtareve, ku dy anëtar zgjedhën nga kuvendi i komunës, dy anëtar zgjedhën drejtë për drejt nga banoret e fshatit Hoçë e Madhe dhe një anëtar zgjidhet nga kisha ortodokse serbe. Kështu që dy përfaqësuesit e fshatit Hoçë e Madhe dhe një përfaqësues te kishës nuk ka te bëjë me komisionin ad hoc pasi ata vijnë drejtpërdrejt te lajmëruar prej tyre kështu që vetëm përfaqësuesit e kuvendit i zgjedh komisioni ad hoc. Sipas ligjit për Hoçën e Madhe ne këtë kuptim po kërkoj që komisioni do te merret vetëm me dy kandidatet që i zgjedh kuvendi që merret vetëm me këta dy emra.

Kryetari – Ligji për themelimin e këshillit te fshatit Hoçë e Madhe, po e them edhe njëherë se ata tre vende te rezervuara janë nga Hoça e Madhe, ku njeri është kisha ortodokse dhe dy nga banoret e fshatit. Por ky komisioni ad hoc për shkak te numri te madhe te aplikacioneve që kanë aplikuar atëherë nuk duhet me ja lanë barrën kuvendit te komunës sepse i del problem, kështu që më mirë me i lanë ata ne komisionin ad hoc sepse kanë me i shqyrtue secilin aplikacion veç e veç me përjashtim te aplikacionit nga kisha ortodokse sepse ai caktohet me vendim që e kanë komisionin e vet nga kisha. Pra ky komision ad hoc do ti shqyrtoj te gjitha aplikacionet që aplikojnë për këshill.

Isak Hoti – Komisioni është diçka tjetër që do ti për zgjedh këta që kanë aplikuar. Ky udhëzim administrativ nuk ka mundësi shume me ndryshue, pasi prape do te jetë i njëjtë udhëzimi administrativ dhe ka me u bo me u ndryshue dhe me u plotësue. Sa i përket komisionit ad hoc prape do te jetë dhe ne baz te praktikës që nga viti 2012-2013 që ka hie ne fuqi ligji e kemi ndjekë te njëjtën procedurë te udhëzimi administrativ 1.5 ku thotë, kuvendi i komunës e zgjedh komisionin ad hoc dhe ky nuk ka mundësi me ndryshue as ne plotësim ndryshim te udhëzimit që vjen, por ne momentin që diçka nuk është ne fuqi atëherë duhet m bo ne bazë te praktikës. Kështu që një gje duhet te ju them se edhe ne këto momente OSBE-ja është duke na përcjell dhe nuk dua me pas edhe njëherë ne kuvend këtë pikë te rendit te ditës. Po e potencoj edhe njëherë ligjin, ku thotë themelimi i komisionit ad hoc, ku kuvendi i komunës nxjerr vendim e komisionit ad hoc dhe pas nxjerrjes se vendimit nga paragrafi 1.1 te këtij neni shpallen ftesat publike sipas secilës paraqesin kandidatet e tyre për tu bërë anëtar te këshillit në afat prej 15 ditëve, kështu që nuk mundemi me dal jashtë kësaj që e thotë ligji.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, sa mundem me kuptue rreth kësaj pike te rendit te ditës, propozimi i Burimit mendoj se qëndron ligjërisht kështu edhe e shpjegoj se ka te bëjë me komisionin ad hoc edhe qenka mundësi me u bo ne këtë fom nga kuvendi. Mirëpo pasi që është rast i ndjeshëm dhe mund te kemi pasoja sikur që u cekë dhe që është evidente sepse kemi te bëjmë me një rast tepër specifik që komuna ka pasur problem te vazhdueshme me vite me radhë dhe ky komision besoj që nuk ndonjë peshë shume te madhe që mundet me ndryshue diçka rreth këtij ligji atëherë është mirë te votohet dhe te kryhet puna se me lehtë pasi që nuk besoj që është interes i askujt këtu që te behet ndonjë ndryshim këtu ne favor te këtij komuniteti apo te banoreve të fshatit Hoçë e Madhe. Pra nëse nuk ka peshë ky komision ad hoc per ndonjë ndryshim eventual atëherë besoj që duhet te vendoset ne votim dhe te kalojmë tutje mirëpo gjithashtu e arsyetoj edhe propozimin e burimit sepse e dha me fakte e me argumente edhe qëndron kjo, por përsëri duhet te marrim per bazë edhe praktikën apo formën që e shpjegoj zyrtari ligjor që te mos kemi telashe me tutje.

Kryesuesi – Atëherë e qesim ne votim propozim vendimin për caktimin e komisionit ad hoc për shqyrtimin e kërkesave t kandidatëve që kanë konkurruar për Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe. Konstatoj se unanimisht miratohet pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e shtatëmbëdhjetë te rendit te ditës:

17. Shqyrtimi i plotësim ndryshim te vendimit 01/272, të datës 28.02.2022 për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit te fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi – E qesim ne votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e shtatëmbëdhjetë e rendit te ditës.

18. Shqyrtimi i Propozim vendimit për caktimin e komisionit ad hoc për shqyrtimin e kërkesave te kandidatëve që kanë konkurruar për Këshillin e fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi – Atëherë kemi dy anëtar prej kuvendit komunal e plotësojnë komisionin ad hoc për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe për përzgjedhjen e anëtareve që kanë konkurruar. A kemi propozime nga grupet e asamblistëve dhe është mirë që çdo propozim me vendos ne votim për përzgjedhjen e dy anëtareve nga kuvendi komunal.

Besë Bytyqi – Grupi i asamblistëve te AAK-së për këtë komision e propozon asamblistin Hasan Përboqin.

Merisa Sharku – grupi i asamblistëve te VV-së propozon Leonard Morina.

Faton Ramadani – Grupi i asamblistëve te LDK-së propozon Lirigzon Kastrati.

Kryesuesi – Atëherë dy prej tre emrave do te përzgjedhjen, kështu që i qesim ne votim, ku nga AAK-ja është Hasan Përboqi, ku e qesim ne votim, ku janë 12 vota pro. Për Leonard Morina nga VV-ja janë 14 vota. Për Lirigzon Kastrati nga LDK-ja janë 15 vota. Kështu që konstatohet se Leonard Morina me 14 vota dhe Lirigzon Kastrati me 15 vota janë anëtarë te komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtareve te këshillit te fshatit Hoçë e Madhe kurse tre anëtarë tjerë te këtij komisioni emërohen nga këshilli i fshatit Hoçë e Madhe.

Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e konstatohet te mbyllur mbledhjen e Kuvendit dhe shihemi ne mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi:


Agim Hoti

